



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Pozita e femrës në institucionet arsimore në Luginën e Preshevës

KANDIDATI:
Mejreme ZEJNULLAHU

MENTORI:
Prof.dr. Arafat SHABANI

Tetovë, 2019

P ë r m b a j t j a

I	Rreth tezës së magjistraturës	
1.1	Hyrje	3
1.2	Abstrakt/Резиме/Abstract	4
1.3	Metodologjia e hulumtimit	10
1.4	Hipoteza	12
1.5	Qëllimi	13
1.6	Rëndësia e punimit	14
II	(PA)BARAZIA NË SHOQËRI	
2.1	Shpjegim i termit të pabarazisë	15
2.2	Gjinia si koncept	17
2.3	Pikëpamjet kryesore të dallimeve gjinore	20
2.4	Feminizmi si reaksion	21
2.5	Feminizmi në kontekstin e shkollimit	23
2.6	Nga përpjekja për barazi deri te integrimi	26
2.7	Diskriminimi sipas gjinisë	28
2.8	Diskriminimi për shkak të orientimit	31
2.9	Vajzat më të goditura edhe nga bulizmi	34
III	SHKOLLIMI INSTRUMENT FUNDAMENTAL I ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË	
3.1	Zhvillimi dhe rëndësia e shkollimit	36
3.2	Shkolla vendi i pabarazive	40
3.3	Përfshirja në institucionet edukative – arsimore sipas gjinisë	42

3.4	Përmbysje e raporteve gjinore në arsimit universitar	47
3.5	Gratë më të interesuara për kualifikime në moshë të rritur	51
IV SHKOLLIMI NË LUGINËN E PRESHEVËS, BUJANOVCI DHE MEDVEGJËS		
4.1	Historia e shkollimit, vajzat që në “Iptidaie“	52
4.2	Zgjerimi dhe represioni politik	56
4.3	Librat promotorë të pabarazisë gjinore	58
4.4.	Paragjykimet në ndarjen e roleve gjinore	60
4.5	Femrat drejtojnë dy nga 9 shkollat e Preshevës	62
4.6.	Drejtimet e “vajzave” dhe drejtimet e “djemve”	64
V. NUMRA, MUNDËSI DHE QASJE TË KRAHASUESHME		
5.1	Struktura e popullsisë në Bujanoc e Preshevës sipas nivelit të shkollimit	67
5.2	Pozita e grave në planet strategjike zhvillimore në Bujanoc dhe Preshevë.....	71
5.3	Anketa dhe rezultatet	75
5.4	Përfundimi	80
5.5	Rekomandimet	81
5.6	Bibliografia & Webografia.....	82

Hyrje

Pozita ose barazia gjinore është njëra ndër vlerat themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë. Prandaj është detyrë e tërë shoqërisë që të mënjanoj pengesat duke garantuar sjellje, pozitë, mundësi dhe përfitime të barabarta për të dy gjinitë në të gjitha sferat e jetës. Çdo trajtim jo i barabartë i një individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë gjinorë. Çështja e pozitës-barazisë gjinore e ka përcjellë shoqërinë njerëzore në të gjitha etapat e zhvillimit të saj. Kjo temë është ngritur shumë herë në nivel të debatit shoqëror, ndërsa merr një vlerë ende më të madhe kur synon të zgjidh probleme të kësaj natyre në institucionet arsimore.

Përfaqësimi i drejtë i grave, qoftë në nivel të numrit të nxënësve, studentëve, mësimdhënësve, drejtuesve të shkollave e fakulteteve dhe institucioneve tjera të cilat krijojnë e kontrollojnë politikën arsimore duhet të jetë një imperativ i kohës për shoqërinë shqiptare e në rastin e këtij hulumtimi për shqiptarët e Luginës të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Institucionet që përfaqësojnë shqiptarët e Luginës duhet të jenë dyfish më të kujdesshëm dhe vigjilent në krijimin e politikave të barazisë gjinore, pasi vetëm kështu mund të arrihet të rikuperohen pasojat që kanë lënë diskriminimet etnike të pranishme në të gjitha hapësirat e ish-RSFJ-së. Në shtetin e Serbisë, i cili trashëgon ish-RSFJ-në, gratë shqiptare ishin dy herë të diskriminuara, pra si shqiptare (në baza etnike) dhe njëkohësisht si gra (në baza gjinore).

Në Luginë nuk është aspak e vështirë të dallosh pozitën e pa barabartë të grave dhe burrave në institucionet arsimore. Kështu në institucionet arsimore të Luginës së Preshevës vërehet dallim i madh sa i takon përfaqësimit të gjinisë femërore si numër (kuantitet) dhe cilësi (kualitet). Konkretisht, numri i nxënësve femra ashtu si edhe i mësimdhënësve femra është më i lartë se sa i djemve. Mirëpo kur vijmë të analizojmë përfaqësimin e femrave në pozita udhëheqëse (drejtoresha, drejtuese të këshillit të shkollës, udhëheqëse të sektorëve për arsim në nivel komune, inspektore të arsimit) femrat janë të përfaqësuara në mënyrë simbolike, për të thënë aspak. Për shembull nga nëntë shkolla fillore dhe dy të mesme, vetëm dy drejtohen nga femra.

Abstrakti

Pozita e grave në shoqëri, sot e kësaj dite paraqet temë interesante për hulumtim nga vetë fakti se të drejtat e tyre, pjesëmarrja, roli, si dhe kontributi që japin në shoqëri janë të ndryshme nga pozitat e njejtë të meshkujve, në vende të ndryshme të botës. Madje, edhe në shtetet me demokraci të zhvilluar sikurse janë vendet nordike, apo edhe në ata shtete që kanë traditë sa i përket barazive gjinore nuk mungojnë dallimet të cilat ekzistojnë mes grave dhe burrave. Sistemi arsimor i analizuar në aspektin e përfaqësimit të gjinive është gjithashtu një pikë referimi që tërheqë vëmendjen e studiuesve, pasi kemi të bëjmë me një fushëveprim i cili tregon të gjithë njerëzit, pavarësisht dallimeve të tyre e të cilat mund të jenë: biologjike, sociale, ekonomike, kulturore, gjuhësore, fetare, të orientimeve seksuale, e kështu me radhë.

Në këtë pikë, reflektohet gjerësisht situata reale sa i përket statusit të grave në shoqëri, respektivisht pozitës së tyre në institucionet arsimore, sepse statusi apo pozita e tyre është rezultat i drejtpërdrejtë i faktorëve të lartpërmendur. Këtu, në të njëjtën kohë pasqyrohet edhe mentaliteti i rrethit, rendi juridik e politik të shtetit si dhe zhvillimi ekonomik e kulturor i shoqërisë së cilës i takojnë. Edhe në Luginën e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit nuk është aspak e vështirë të dallosh pozitën e pa barabartë të grave dhe burrave në institucionet arsimore. Si në kategorinë e nxënësve/studentëve ashtu edhe në kategorinë e mësimitdhënësve, drejtuesve dhe niveleve më të larta të drejtimit të institucioneve arsimore, ka dallime të theksuara gjinore në disfavor të grave.

Kështu në institucionet arsimore të Luginës së Preshevës vërehet dallim i madh sa i takon përfaqësimit të gjinisë femërore si numër (kuantitet) dhe cilësi (kualitet). Konkretisht, numri i nxënësve femra ashtu si edhe i të mësimitdhënësve femra është më i lartë se sa i djemve. Mirëpo kur vijmë të analizojmë përfaqësimin e femrave në pozita udhëheqëse (drejtoresha, drejtuese të këshillit të shkollës, udhëheqëse të sektorëve për arsim në nivel komune, inspektore të arsimit) femrat janë të përfaqësuara në mënyrë simbolike, për të mos thënë aspak. Për shembull nga nëntë shkolla fillore dhe dy të mesme, vetëm dy drejtohen nga femra, apo e shprehur me përqindje pjesëmarrja e tyre në këto instanca nuk i afrohet as 20 për qindëshit (është 18 %). Përveç kësaj ekziston dallim edhe në shkallën e arsimimit, ku përsëri femrat kanë nivelin më të ulët krahasuar me djemtë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, në Preshevë dhe Bujanoc pjesa më e madhe e të pa punësuarve janë femra, edhe atë nga 3.196 të papunë në Preshevë, 2.173 janë femra, kurse 1.023

meshkuj. Në Bujanoc është gjithashtu e njëjta situatë. Nga 2.448 të papunë 1.466 janë femra kurse 982 djem¹

Shqetësuese është se pabarazinë gjinore e vërejnë edhe vetë nxënësit, të cilët për fat të keq vazhdojnë të ushqejnë paragjykime ndaj njëri tjetrit kur janë në pyetje aftësisë dhe profesionet që duhet të kenë në jetë vajzat dhe djemtë, respektivisht gratë dhe burrat. Për pasojë edhe statusi social i gjinive në shoqëri është i ndryshëm. Gratë kanë shkallë më të lartë të papunësisë se sa burrat.

Barazia gjinore (equality) edhe ashtu trajtohet si një parim, mbi bazën e të cilit të gjitha qeniet njerëzore pa dallim gjinie, race, bindje fetare, statusi social, kulturor e politik duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta. Fundja, kjo është pjesë e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Barazia gjinore, është në radhë të parë pjesë e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) dhe pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAË) të vitit 1979. Konventa, e cila është ratifikuar nga më tepër se 100 shtete në mënyrë të qartë përcakton diskriminimin e grave si shkelje të të drejtave të njeriut.

Fjalë kyçe: Pabarazi gjinore, pjesëmarrja e grave në institucionet arsimore, feminizëm, shkollat në Luginën e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, mentalitet patriarkal, gra në veprim

¹ Tabela numër 3

Апстракт

Позицијата на жените во општеството денес е интересна тема за истражување од самиот факт дека нивните права, учество, улога и придонес што им го даваат на општеството се различни од истите позиции на мажите во различни земји светот. Дури и во земјите со развиени демократии, како што се нордиските земји, па дури и оние земји кои имаат традиција во поглед на родова еднаквост, нема недостаток на разлики помеѓу жените и мажите. Образовниот систем анализиран во однос на родовата застапеност е исто така референтна точка која го привлекува вниманието на научниците, бидејќи се однесува на полето на дејствување кое ги поврзува сите луѓе, без разлика на нивните разлики, кои можат да бидат: биолошки, социјални, економска, културна, јазична, верска, сексуална ориентација и тн.

Во овој момент, реалната ситуација се рефлектира во однос на статусот на жените во општеството, односно нивната позиција во образовните институции, бидејќи нивниот статус или позиција е директен резултат на споменатите фактори. Тука, истовремено, го одразува менталитетот на кругот, правниот и политичкиот поредок на државата, како и економскиот и културниот развој на општеството на кое им припаѓаат. Дури и во Прешево, Медвеѓа и Бујановац долини, воопшто не е тешко да се препознае нерамноправната положба на жените и мажите во образовните институции. И во категоријата ученици / студенти и во категоријата наставници, раководители и повисоки нивоа на управување со образовните институции, постојат значителни родови разлики во положбата на жените.

Така, во образовните институции во Прешевската долина постои голема разлика во застапеноста на женскиот пол како количина (квантитет) и квалитет (квалитет). Поточно, бројот на женски ученици, како и на женските наставници е повисок од оној на момчињата. Но, кога ќе дојдеме да ја анализираме застапеноста на жените на лидерски позиции (директор, училишни советници, лидери во образовниот сектор, инспектори за образование), жените се симболички претставени, а да не зборуваме воопшто. На пример, во девет основни и средни училишта, само две се водени од жени, или изразени во проценти, нивното учество во овие случаи дури не се приближува до 20 проценти (18 проценти). Покрај тоа; постои разлика во нивото на образование, каде што жените повторно имаат најниско ниво во споредба со момчињата. Според податоците на Државниот завод за статистика, во Прешево и во Бујановац, најголем дел од невработените се жени, а од 3.196 невработени во

Прешево, 2.173 се жени и 1.023 мажи. Исто така, ситуацијата е и Бујановац. Од 2.448 невработени 1.466 се жени и 982 момчиња.

Загрижува фактот што родовата нееднаквост е забележано и од самите студенти, кои, за жал, продолжуваат да се злоупотребуваат кога станува збор за вештините и професиите што момчињата и девојчињата, односно жените и мажите, мора да живеат. Како резултат на тоа, социјалниот статус на половите во општеството е различен. Жените имаат повисоки стапки на невработеност од мажите.

Еднаквоста исто така се третира како принцип, врз основа на кој сите човечки суштества, без оглед на пол, раса, верско уверување, социјален, културен и политички статус треба да имаат еднакви законски права. Впрочем, ова е дел од меѓународните човекови права. Родовата еднаквост првенствено е дел од Универзалната декларација за човекови права (1948) и дел од Конвенцијата на Обединетите нации за елиминација на сите форми на дискриминација врз жените (CEDAЃ) од 1979 година. Конвенцијата, која е ратификувана од повеќе од 100 држави јасно ја дефинира дискриминацијата на жените како кршење на човековите права.

Клучни зборови: *Родовата нееднаквост, учеството на жените во образовните институции, феминизмот, училиштата во Прешевската долина, Медвеѓа, Бујановац, патриархализам*

Abstract

Today the position of women in society is an interesting topic for research by the very fact that their rights, participation, role and the contribution that they give to society are different from the same positions of men in different countries worldwide. Even in so called developed countries such as the Nordic countries, or even those countries that have tradition in terms of gender equality, there is no lack of the differences between women and men. The educational system analyzed in terms of gender representation is also a point of reference that draws the attention of scholars, as it relates to a field of action that ties all people, regardless of their differences, which can be: biological, social, economic, cultural, linguistic, religious, sexual orientation, and so on.

At this point, the real situation is reflected in terms of the status of women in society, respectively their position in educational institutions, because their status or position is a direct result of the aforementioned factors. Here, at the same time, reflects the mentality of the circle, the juridical and political order of the state, as well as the economic and cultural development of the society to which they belong. Even in the Presevo, Medvedja and Bujanovac valleys, it is not at all difficult to discern the unequal position of women and men in educational institutions. In both category of students / teachers, managers and higher levels of management of educational institutions, there are significant gender differences in the disadvantage of women.

This in the Educational Institutions of the Presheva Valley there is a great difference in the representation of female gender as quantity and quality. Specifically, the number of female students as well as female teachers is higher than that of males. But when we come to analyze the representation of women in leadership positions (director, school councilors, education sector leaders, inspectors of education), women are symbolically represented, not to mention at all. For example, in primary and secondary schools, only few are run by women, or expressed in percentage, their participation in these instances is not even approaching 20 percent (18 percent). In addition; there is a difference in the level of education, where women again have the lowest level compared to male. According to the data of the State Statistical Office, in Preševo and Bujanovac, the largest part of the unemployed are women, and that of 3,196 unemployed in Presevo, 2,173 are women, and 1,023 men. Bujanovac is also the same situation, from where 2,448 unemployed, 1,466 are women and 982 male.

It is a concern that gender inequality is also noticed by the students themselves, who unfortunately continue to abuse each other when it comes to the skills and professions that female and male, respectively women and men, have to live in. Consequently, the social status of genders in society is different. Women have higher rates of unemployment than men.

Equality is also treated as a principle, on the basis of which all human beings regardless of gender, race, religious belief, social, cultural and political status should have equal legal rights. After all, this is part of international human rights. Gender equality is primarily part of the Universal Declaration of Human Rights (1948) and part of the United Nations Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (CEDAW) of 1979. The Convention, which is ratified by more than 100 states clearly defines women's discrimination as a violation of human rights.

Key words: Gender Inequality, women's participation in educational Institutions, Feminism, Schools in Presevo Valley, Medvedja, Bujanovac,

1.3 Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi për këtë punim magjistrature është gërshetim i metodave të cilat pasqyrojnë dhe në të njëjtën kohë analizojnë situatën faktike sa i përket hipotezës kryesore dhe hipotezave tjera të punimit. Meqë Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit janë pjesë juridike e Serbisë, për të pasqyruar dhe analizuar situatën janë marrë në konsideratë ligjet dhe dokumentet zyrtare të këtij shteti. Por meqë, pjesa dërmuese e popullatës është shqiptare, janë marrë parasysh edhe përvojat e vendbanimeve tjera shqiptare, veçanërisht Kosovës dhe Shqipërisë. Prandaj, përveç dallimeve gjinore në raportin mes Luginës nga njëra anë dhe nga ana tjetër Pçinjës (rajoni ku graviton Lugina) dhe Serbisë (shtet në të cilin bën pjesë), analiza bëhet edhe në rrafshin socio-ekonomik e kulturor. Padyshim se për të shpjeguar fenomenin e ndasive kam konsultuar edhe literaturë si dhe rezultatet e hulumtimeve të bëra në nivel rajonal dhe botëror.

Për të parë në teren se si qëndron situata sa i takon temës sonë, kam vizituar disa ditë dy shkollat e mesme dhe disa fillore; kam biseduar me nxënës, arsimtarë/e, kam intervistuar drejtorë, inspektorë dhe gjithashtu kam anketuar nxënësit, me qëllim që të kuptohen nga afër problemet dhe burimet e tyre.

Gjatë analizës u jam referuar: dokumenteve, strategjive, ligjeve dhe të dhënave statistikore, si dhe deklaratave të personave zyrtarë (ministra, deputetë, drejtorë shkollash) Aty, ku ka qenë e pamundur sigurimi i informacionit të drejtpërdrejtë, për fenomene të caktuara, janë shfrytëzuar mënyrat e konfirmimit me burime “dytësore”, pra përmes bisedave formale dhe jo formale me profesorë, nxënës, prindër, gazetarë. Është realizuar, gjithashtu një anketë me 60 nxënës të dy shkollave të mesme dhe një shkollë fillore, duke mbajtur llogari për përkatësinë gjinore dhe moshën e tyre. Pra, gjysma e të anketuarve janë djem dhe gjysma vajza, ndërsa $\frac{3}{4}$ janë nxënës të shkollave të mesme (Gjimnazit “Skënderbeu” dhe Shkollës të mesme teknike “Presheva”) kurse $\frac{1}{4}$ nxënës të klasave të shtata dhe të teta të shkollës fillore “Ibrahim Kelmendi”. Ajo, që bie në sy është se qëndrime mbi pabarazitë gjinore (diskriminimin) nxënësit nisin të krijojnë kur janë në moshë pak më të madhe, në shkollë të mesme. Sepse, sipas përgjigjeve të nxënësve, 85 për qind e filloristëve deklarojnë se nuk dinë nëse në shkollë ka diskriminim ose jo.

Te nxënësit e shkollave të mesme, kjo kategori nxënësish nuk kalon 25 për qindëshin. Por, te nxënësit e shkollave të mesme përveç; tjerave bie në sy “egoizmi” si pjesë e karakterit psikologjik të nxënësve. Suksesin e vajzave në mësim, pra notat më të mira djemtë në masë të madhe ua faturojnë tipareve fiziologjike. Konkretisht 72.5 për qind e

djemve thonë se vajzat marrin nota më të mira sepse 'janë vajza-gjinia e bukur 12djem kanë rrethuar përgjigjen "a" ose 17djem kanë rrethuar përgjigjen "b" sepse vajzat janë të urta, 8 djem kanë rrethuar përgjigjen "c" sepse mësojnë më shumë, si dhe 3 djem kanë rrethuar përgjigjen "d" nuk marrin nota më të mira. Me të njëjtin botëkuptim perceptohen edhe djemtë nga ana e vajzave.

Në pyetjen numër 4 "Djemtë", marrin nota më të mira se vajzat". a) sepse bëhen shokë me profesorët, b) sepse janë më të fortë, c) sepse mësojnë më shumë dhe d) nuk marrin nota të mira, edhe te vajzat është tendenca që suksesin e mësimdhënësve te djemtë ta shohin të atribuuar nga faktorë të tjerë. Kështu 15 vajza janë përgjigjur me variantin "a", 8 janë përgjigjur me variantin "b", 12 me variantin "c", 5 me variantin "d". Pra, si djemtë ashtu edhe vajzat e përshkruajnë shumë pak suksesin e gjinisë së kundërt me meritokracinë. Vetëm 8 nga 40 djem mendojnë se vajzat i meritojnë notat, pra marrin nota të mira sepse meritojnë më shumë dhe vetëm 12 nga 40 vajza mendojnë të njëjtën gjë për djemtë.

.3.1 Metodatat dhe instrumentet

Përmes metodës të kërkimit empirik janë sjellë të dhëna nga terreni, të mbështetura me analiza, dokumente dhe statistika zyrtare. Aty ku nuk kishte mundësi të realizohet ky bashkërendim, informacioni i nevojshëm është siguruar përmes formave tjera: kontakteve dhe burimeve të besueshme brenda shkollave, si dhe institucioneve tjera kompetente në sferën e arsimit – si instrumente për verifikimin e hipotezës të punimit.

Janë përdorur disa metoda të hulumtimit: vëzhgimi, intervista e strukturuar dhe gjysmë e strukturuar, anketimi, qasja në dokumente të hartuara nga Ministria e Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe Enti Shtetëror i Statistikave, të Serbisë.

1.4 Hipoteza kryesore

Faktorë të ndryshëm socio-kulturor kanë bërë që pozita e grave në institucionet arsimore të mos jetë e barabartë me atë të burrave. Pavarësisht dispozitave ligjore dhe përpjekjeve që bëhen kohëve të fundit, barazia gjinore nuk është arritur plotësisht sidomos kur është fjala për pozita drejtuese apo edhe për prezencën e grave në instanca më të larta të institucioneve të sistemit arsimor.

1.4.1 Hipoteza të tjera

1. Mentaliteti patriarkal, por edhe disa rrethana historike (specifike për shqiptarët e hapësirave të ish-Jugosllavisë) janë faktorë kryesor të pabarazisë gjinore. Kjo mund të vërehet lehtë edhe në institucionet arsimore të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit

2. Pabarazia gjinore, e pranishme në të gjitha hallkat e shoqërisë, ndikon drejtpërdrejtë edhe në performacën e dobët të zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror në Luginën e Preshevës.

3. Pa barazi të plotë gjinore në Luginën e Preshevës, nuk mund të ketë as barazi politike, ekonomike e kulturore të shqiptarëve të Luginës në shtetin e Serbisë

1.5 Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të kontribuojë në përmirësimin e përfaqësimit cilësor të grave në institucionet e sistemit arsimor, pra të nxis dhe të kërkojë pjesëmarrjen e saj në pozita vendimmarrëse. Krahas kësaj të ndihmojë në krijimin e një pasqyre të detajuar të pozitës së grave në sistemin arsimor si dhe të sensibilizojë problematikat të cilat e kanë frenuar vendosjen e deritanishme të barazisë gjinore, të analizuara çdo herë në kontekstin e qëllimit kryesor.

Një klasë pa prezencë të barabartë të vajzave dhe djemve, një shkollë me shumë më pak mësuese sesa mësues, apo edhe me organe që drejtohen vetëm nga burrat nuk ka si të jetë as model për barazi gjinore dhe as motiv dhe mbështetje për politika të barabarta. Përkundrazi, në formimin intelektual të nxënësve/gjeneratave të reja do të luajë rolin e atij instrumenti që kultivon pabarazinë gjinore si diçka normale, apo si një pozitë që duhet të funksionojë si e tillë.

Pra këtu gërshetohen të gjithë faktorët social, kulturor e politik të cilët përveç se janë refleksion i gjendjes kolektive përbëjnë edhe predispozitën e zhvillimit të mëtutjeshëm, pra drejtimit që do të merr shoqëria në të ardhmen. Shkolla dhe të gjitha institucionet që burojnë nga sistemi arsimor, në radhë të parë shërbejnë si modele tek e cila duhet të mbështetet shoqëria dhe padyshim që orientojnë zhvillimet e përgjithshme.

1.6 Rëndësia e punimit

Për një shtet modern dhe shoqëri multietnike, sikurse pretendojmë të jemi, barazia gjinore² është parimi bazë mbi të cilin duhet ndërtuar të gjitha politikat dhe strategjitë zhvillimore. Pa u arritur një gjë e tillë, nuk mund të synohet as ardhmëria evropiane dhe as kohezioni i brendshëm shoqëror. Nga ky këndvështrim duhet parë edhe rëndësia e hulumtimit mbi pozitën e grave në institucionet e sistemit arsimor në luginën e Preshevës, pasi këtu jemi përpjekur jo vetëm të përshkruajmë gjendjen reale dhe ta krahasojmë atë me pozitën e grave në vende të tjera (Serbi, Kosovë, Shqipëri, e gjetkë) por edhe të propozojmë forma efikase për eliminimin e tyre.

Për pabarazinë gjinore, flitet në një sërë dokumentesh të karakterit arsimor, ekonomik, kulturor e politik të shqiptarëve të Luginës. *“Pa pjesëmarrjen aktive të grave në procesin e ndërtimit të shoqërisë tonë si një vend modern, evropian të profilizuar dhe demokratik, nuk është i mundur realizimi i demokracisë, barazisë së progresit social”³*. Shoqëria në përgjithësi do të frymojë më lirshëm, “me të dyja mushkëritë”, do të funksionojë me të gjithë kapacitetin e plotë në saj si një tërësi e pandarë, apo “gjysma e njerëzisë” sikurse shprehet poeti i madh Naim Frashëri. *“Si mund të vejë mbroth një komb kur gratë, domethënë gjysma e njerëzisë rron e mbyllur si në kuvli? Si mund të jetë i zgjuar e i mbarë një komb pa pasur në vijë jetën e shtëpisë e të fëmijës... Gruaja duhet të jetë e mësuar më shumë nga burri se fëmija së pari nga mëma e marrin arsimin dhe mësimet... Gruaja është mëmë e fëmijës, zonjë e shtëpisë dhe i krejt njerëzisë”*, porosiste ai.

Me ngushtimin e hendekut të dallimeve gjinore, që ekziston sot e kësaj dite për shqiptarët e Luginës por në përgjithësi edhe për shtetin serb (pjesë administrative juridike e së cilës është Lugina) do të vihen në zbatim edhe predispozitat ligjore dhe obligimet që dalin nga konventat ndërkombëtare, të nënshkuara dhe ratifikuara nga Parlamenti i Serbisë. Por mbi të gjitha, gjysma e shoqërisë – gratë, do të gëzojnë të drejtat e tyre dhe do të fitojnë statusin e merituar nga e cila do të përfitojnë të gjithë, pra edhe burrat.

² Gjinia - në kuptimin e seksit, si kategori biologjike

³ Planin Strategjik Zhvillimor i Komunës së Preshevës (2011-2017)

II (PA)BARAZIA NË SHOQËRI

2.1. Shpjegim i termit të pabarazisë

Pabarazia është dukuri të cilën e gjejmë në thuajse çdo sferë të jetës, pa përjashtuar këtu edhe shkollimin ku pabarazia/diskriminimi vijnë në trajta dhe forma të ndryshme. E, meqë shkollat dhe institucionet tjera arsimore përbëjnë interes publik është mjaft e rëndësishme të hulumtohet se në çfarë mase është i pranishëm fenomeni i pabarazisë dhe se cilat janë format më të shpeshta të saj.

Fjalori i Kembrixhit (Camrigh Dictionary) e paraqet pabarazinë si “situatë të pa drejtë në shoqëri, kur disa njerëz kanë më shumë mundësi, para, dhe gjëra të tjera krahasuar me njerëz të tjerë. (*The unfair situation in society when some people have more opportunities, money, etc. than other people*)⁴. Në Camrigh Dictionary jepet gjithashtu vlerësimi se “Ligji ka bërë pak për ta parandaluar diskriminimin racor dhe pabarazinë (*The law has done little to prevent racial discrimination and inequality*)⁵. Ndërkaq sinonimi më i shpeshtë i pabarazisë sikurse qëndron në po këtë fjalor është diskriminimi (*discrimination*). Kuptimi i parë për këtë term është: trajtimi i personit ose grupit të veçantë të popullatës së ndryshme në mënyrë veçanërisht të keqe, me të cilin shkelen të drejtat e njerëzve të tjerë për shkak të ngjyrës së tyre të lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, e të tjera (*Treatment of a particular person or group of different populations in a particularly bad way by which the rights of other people are violated because of their skin color, gender, sexual orientation, etc*). Kuptimi i dytë: aftësia për të parë ndryshime ndërmjet dy gjërave apo njerëzve (*The ability to see the difference between two things or people*).

Sakaq, Fjalori i Oxfordit (Oxford Dictionary) e paraqet pabarazinë (inequality) si: ndryshimi në madhësi, shkallë, rrethanë e të tjera; si mungesë të barazisë. (*Different in size, degree, circumstance, ect; lack of equality*)⁶. Ky term gjen shpjegim edhe në Fjalorin e Biznesit (Buisnnes Dictionary) dhe ku pabarazia shpjegohet si: dallimet në të ardhura për kokë banori ose të ardhurat familjare për të gjithë popullsinë brenda një vendi ose në vende

⁴ <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/inequality>

⁵ Po aty

⁶ <https://en.oxforddictionaries.com/definition/inequality>

të ndryshme. (*Differences in per capita income or household income across populations within a country or across countries*)⁷.

E analizuar në prizmin e shpjegimeve të tria këtyre fjalorëve prestigjioz, sa i përket pabarazisë (në rastin e këtij hulumtimi në pabarazisë gjinore në sistemin arsimor) del se ajo është e pranishme në kuptimin e mirëfilltë të atyre shpjegimeve. Si në Luginë, Serbi, shtetet e rajonit, ashtu edhe në shtete e zhvilluara evropiane ekzistojnë rastet e pabarazive për arsye nga më të ndryshmet. Burimi i pabarazisë/diskriminimit brenda sistemeve arsimore vjen për shkak të moshës, gjinisë, aftësive fizike, statusit social, përkatësisë nacionale, gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, e kështu me radhë.

Natyra e burimit të pabarazive është e ndryshme, por të gjitha ata gërshetohen me njëra tjetër dhe krijojnë situata shpesh herë komplekse dhe në shumë raste vështirë të kapërcyeshme, sepse që të ndryshohet kjo gjendje duhet të intervenohet në ndryshimin e mentalitetit, rendit juridik e politik, e të ngjashme.

⁷ <http://www.businessdictionary.com/definition/income-inequality.html>

2.2. Gjinia si koncept

Kur flasim për gjininë si përkatësi, studimet e shumta që janë bërë në frymën e dallimeve që ekzistojnë mes dy gjinive të kundërta (femër/mashkull) kanë shtjelluar edhe dallimet konceptuale që ekzistojnë mes gjinisë dhe seksit. Mirëpo, interpretimet që jepen në fjalorët e gjuhës shqipe, të krijojnë përshtypjen se kemi të bëjmë me sinonim fjalësh (pra e njëjta gjë e thënë me fjalë të ndryshme). Kështu fjala “*gjin*” shpjegohet si: *Tërësia e tipareve natyrore, që dallojnë mashkullin nga femra dhe që i përcaktojnë secilit rolin e veçantë në riprodhimin e llojit; seks*⁸. Gati se pa dallime konceptuale është edhe shpjegimi i fjalës “*seks*”. Konkretisht: *Tërësia e tipareve natyrore, që dallojnë mashkullin nga femra dhe që i përcaktojnë secilit rolin e veçantë në riprodhimin e llojit; gjini*⁹. Pra, përkufizimet të japin përshtypjen se *seks* dhe *gjin* janë sinonime të njëra-tjetrës, edhe pse sociologët i përdorin të dy termat në mënyrë të diferencuar. Edhe atë, termi përkatësi gjinore përdoret si kategori konceptuale, d.m.th. me një kuptim shumë specifik. Ndërkaq, termi seks ka të bëjë me karakteristikat biologjike që lidhen me të qenët femër apo mashkull. Sipas këtij koncepti, ne të gjithë lindim të njëjtë dhe ndryshojmë vetëm nga organet seksuale. D.m.th. përkatësia gjinore, atributet, mundësitë dhe marrëdhëniet janë të ndërtuara dhe mësohen nga shoqëria gjatë procesit të socializimit. Që në vitin 1949, kur Simone de Beauvoir, botoi në vëllimin e parë të veprës “*Seksi i dytë*”, bëri dallimin midis femrës dhe gruas. “*Grua nuk lind por bëhesh*”, shprehet ajo.

Me zhvillimin e shoqërive dhe përpjekjeve për të luftuar pabarazinë gjinore, statusi i grave në shoqëri shihet nga pozita dhe dimensione të ndryshme, Kështu, Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovës, në broshurën “*Përkufizimet dhe konceptet gjinore*”¹⁰, flet për gjininë si: a). *përkatësi (gender)*; b). *dallim*, c). *gjendje*; ç). *Drejtësi dhe d). drejtësi thelbësore*.

⁸ Fjalori i gjuhës sotme shqipe, Tiranë 1980 Akademia e shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. fq. 620

⁹ po aty, fq. 1739

¹⁰ Ribotim i vitit 2012, Prishtinë

A). **Përkatësia gjinore (gender)** i referohet mundësive dhe atributëve sociale që lidhen me të qenit burrë apo grua, vajzë apo djalë, si dhe marrëdhënieve mes grave dhe burrave. *Gender* përcakton se çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet tek një grua apo tek një burrë në një kontest të caktuar. Në shumicën e shoqërive ka diferenca dhe pabarazi midis grave dhe burrave për sa i përket përgjegjësive që u caktohen, aksesit (qasjes) ndaj burimeve si dhe mundësive për të marrë vendime. Në fakt *Gender*, sikurse thuhet aty, duhet parë si pjesë e një kontesti socio-kulturor më të gjerë: klasave, racës, mirëqenies sociale, grupit etnik, moshës e kështu me radhë. Nga ky kontekst varen edhe marrëdhëniet në kuptimin e pushtetit mes burrave dhe grave, të cilat manifestohen në çdo pore të jetës, pra ndarjen roleve në familje, punë, shoqëri e që vijnë si rezultat i paracaktimit të normave të sjelljes, pritjeve, ambicieve dhe pozitës që çdo shoqëri ka për burrat dhe gratë. Nga kjo varen edhe pozitën në kuptimin e statusit që kanë gratë në raport me burrat dhe me veten e tyre.

B). **Dallimet gjinore (gender differences)**, kanë paraqitur çdo herë gjendje me interes jo vetëm për studiuesit por edhe për fenomene dhe dukuri që burojnë prej atyre dallimeve dhe që shpërfaqen përmes formave të ndryshme: nga diskriminimi deri te fuqizimi, nga nënshtrimi deri te lëvizjet feministe dhe gratë në zhvillim. Në hapësirën mes kësyer ekstremeve (nënshtrimit dhe sforcimit) qëndrojnë barazia (equality) dhe drejtësia (equity) që pavarësisht ngjashmërive nuk janë e njëjta gjë.

C). **Barazia gjinore (equality)** është një parim, sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore pa dallim gjinie (seksi si kategori biologjike) race, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta. Kjo është pjesë të drejtave ndërkombëtare të njeriut, ku koncepti ligjor i barazisë gjinore është si në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAË) të vitit 1979. Konventa, e cila është ratifikuar nga më tepër se 100 shtete në mënyrë të qartë përcakton diskriminimin e grave si shkelje të të drejtave të njeriut. *“Diskriminimi kundër grave dhuron parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor”*, qëndron aty. Në vitin 1995, në Pekin të Kinës, qeveritë e shteteve nga e gjithë bota riafirmuan angazhimin e tyre për “të drejtat e barabarta dhe dinjitetin e lindur njerëzor të gjitha grave dhe burrave” sikurse qëndron në Deklaratën e Platformës për Veprim.

Ç. **Drejtësia gjinore (equity)**, sakaq, merret me promovimin e barazisë personale, shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë. Termi drejtësi gjinore lindi nga të kuptuarit gjithnjë e më shumë të padrejtësive të kudo gjendura në shoqëri, stereotipive të ushqyera tradicionalisht dhe praktikave diskriminuese, të cilat kanë rezultuar me zhvlerësimin sistematik të qëndrimeve, veprimtarive dhe aftësive që i atribuohen vajzave dhe grave, duke krijuar opinione negative për ta. Prandaj, në pjesën më të madhe të nismave për drejtësinë gjinore fokusi vendoset mbi përmirësimin e kushteve dhe qëndrimeve që prekin vajzat dhe gratë.

Deri vonë, termat barazi dhe drejtësi gjinore, jo vetëm që ngatërroheshin por përdroreshin në vend të njëra-tjetrës. Studiues të këtyre çështjeve vërejnë se “barazia gjinore i referohet trajtimit të njëjtë apo uniformitetit të sasisë, vlerës dhe intensitetit të masave të marra dhe të zbatuara për burrat dhe gratë”. Do të thotë se barazia gjinore mund të shprehet përmes legjislacionit, ndërkohë që drejtësia gjinore nënkupton “angazhimin që të bëhet çfarë është e nevojshme për të siguruar barazi rezultatesh në eksperiencat e jetës të burrave dhe të grave”. Kësisoj, drejtësia gjinore është e vështirë të shprehet përmes legjislacionit: trajtimi identik mund të kënaq kriterin e barazisë, por jo atë të drejtësisë.

D). **Barazia e rezultatit, ose barazia thelbësore**, nënvizon faktin se barazia në kuptimin e krijimit të shanseve të barabarta mund të mos jetë e mjaftueshme për të riparuar diskriminimin dhe disavantazhin historik të grave. Kështu që në vijën logjike të tendencave për barazi dhe drejtësi gjinore, dekadave të fundit është sensibilizuar ideja e “diskriminimit pozitiv”, konkretisht e krijimit të sforcuar të mundësive për të arritur një shkallë të caktuar të barazisë gjinore.

2.3. Pikëpamjet kryesore të dallimeve gjinore

Dallimet gjinore në kulturën perëndimore janë dominuar nga dy pikëpamje kryesore. Në bazë të **pikëpamjes konservatore** dallimet gjinore midis burrave dhe grave janë kryesisht biologjike dhe për rrjedhojë të pa ndryshueshme. Në shumë kultura dhe në periudha të ndryshme historike perspektiva e tyre akademike nuk hasi kundërshtime dhe u mbështet nga një sërë punimesh, fokusi i të cilave ishte inferioriteti i gjinisë femër. P.sh. gjatë shekullit të 19-të, meshkujt dhe femrat angleze kishin role të ndara sociale; burrat ishin më shumë të lidhur me sferën publike, ndërsa gratë me atë private dhe familjare. Konservatorët “provuan shkencërisht” se nëse gratë fitonin të drejtën e arsimit universitar aftësitë e tyre riprodhuese do të dëmtoheshin. Zhvillimet e kësaj pikëpamje në shekullin e 20-të theksojnë se, dallimet në sjellje midis dy gjinive janë produkt i drejtpërdrejtë i ndryshimeve biologjike midis tyre.

Sipas kësaj teorie, burrat janë më të fortë fizikisht, më pak elastikë, kanë më shumë aftësi matematikore dhe mekanike dhe e perceptojnë botën në bazë të objekteve, ideve dhe teorive. Gratë nga ana tjetër piqen më shpejt fizikisht dhe psikologjikisht, janë më të ndjeshme dhe të përkujdesshme, kanë aftësi shumë të mira komunikuese dhe e perceptojnë botën mbi terma të forta morale dhe estetike. Në librin “Burrat dhe Gratë”, Hutt thotë se burrat dhe gratë janë shumë të ndryshëm dhe për këtë arsye veçoritë e shpërmendura vështirë se ndryshohen. Sipas kësaj teorie, sistemi arsimor shihet si një mjet socializimi që edukon djemtë dhe vajzat të ndërmarrin rolet e tyre “natyrale”; burrat si siguresit e të ardhurave dhe kryetarë të familjes, ndërsa gratë si përkujdes-ëse të familjes.

Pikëpamja e dytë, më **progresive**, i percepton rolet sociale të burrave dhe grave të përcaktuara nga zhvillimet historike, kulturore dhe sociale. Edhe pse rolet sociale janë evolutive dhe i nënshtrohen ndryshimeve, gratë përgjithësisht kanë pasur një pozitë më të ulët në shoqëri sepse shumica e tyre, përfshirë këtu edhe atë perëndimore janë shoqëri patriarkale. Burrat kanë më shumë fuqi se gratë dhe më shumë autoritet për të interpretuar diferencat midis tyre në bazë të stereotipave gjinore. Nga kjo perspektivë ekzistencialistja Simone De Beauvoir, por edhe të tjerë venë theksin tek analizimi i barazisë gjinore si një fenomen kulturor që lind nga idetë dominuese të një epoke ose kulture. Si rrjedhojë arsimimi është një instrument që jep njohuri mbi dallimet gjinore, edhe pse ato cilësohen si të rëndësishme në periudha të veçanta kohore. Arsimi zë një peshë të veçantë në këtë shkollë mendimi sepse shikohet si një mundësi për të siguruar mundësi të barabarta për të dy gjinitë, duke luftuar paragjykimet dhe stereotipat e lidhura me këtë fenomen.

2.4. Feminizmi si reaksion

Pozitat historikisht të pabarabarta të meshkujve dhe femrave në shoqëri dhe realiteti maskilist si reaksion të vetin kanë prodhuar feminizmin apo “lëvizje shoqërore që synon arritjen e barazisë midis sekseve me anë të zgjerimit të drejtave për gratë”¹¹. Kjo lëvizje e ka zanafillën në Angli, në vitet 1890 dhe kishte të bënte me angazhimet e grave dhe burrave për të fituar të drejtën e votës dhe të drejtën arsimimit në fusha të ndryshme për gratë. E drejta e votës u fitua në vitin 1918 në Britani të Madhe, më vonë edhe në SHBA (1928) duke u dhënë grave të moshës 30 vjeçare të drejtën për të votuar. Pas kësaj fitoreje, filloi “vala e dytë “e feminizmit, një tendencë e feministeve që të lartësohet pozita e grave në jetën e tyre private, të familjes¹². Feminizmi prej vitit 1890 u zhvillua në shumë drejtime. Sociologjia Flora S. Kastrati numëron: Feminizmin Liberal, Feminizmin Radikal, Feminizmin Marksist, Feminizmin socialist, etj. Pra, feminizmi si fenomen i “valës së dytë “ ka pasur ndikim të fuqishëm në jetën sociale. Në gjysmën e dytë të shekullit XX ka pasur shumë studime për jetën e gruas , me theks të veçantë pabarazia e sekseve ku disa mendimtarë më shumë flisnin për “gjini”, “patriarkat” dhe rolet e sekseve .

Një pasqyrë mjaft të mirë për zhvillimin e feminizmit dhe rolit në sociologji ka bërë R. A. Vallas, në veprën “Feminizmi dhe teoria sociologjike”. Po ashtu edhe në veprat e sociologëve amerikan Xhesi Bernard dhe Alise Rosi “Gratë akademike“ apo “Bota Femërore“ kemi angazhimet e sociologëve për të ndryshuar mënyrën e të kuptuarit dhe rolit të femrës në shoqëri. P.sh. Alise Rosi kritikonte sociologët për interpretimet tradicionale për pozitën e gruas në familje, shoqëri dhe ekonomi duke i thirrur që të marrin parasysh komponentët biologjike. Në fakt, këto janë përpjekje për t’i tejkaluar gjithë ato padrejtësi dhe pabarazi që i janë bërë femrës gjatë historisë.

Feminizmi si lëvizje zhvillohet edhe sot në drejtime të caktuara, por në thelb të gjitha mbështeten në parimin: të krijohen shanse të barabarta për zhvillim për të dy gjinitë. Dijetarë të shumtë ndajnë mendimin se feminizmi liberal u prin të gjitha drejtimeve tjera feministe, madje ka të atillë si Eisenstein që e cilësojnë si “rrymë kryesore feministe”¹³. Feministja e palodhur Simone de Buvuar, në veprën “Seksi i dytë“ pasqyron pozitën tejet diskriminuese të femrës që nga koha antike. Në antikitet sipas De Buvuar gjejmë shkelle të rënda për gjininë

¹¹ Fjalor sociologjik i Oksfordit , faqe 104

¹² Sociologjia e gjinive, Punim seminarik., UT, doc.dr.Flora Sela Kastrati

¹³ Feminizmi modern dhe postmodern, Dr.Zekije Demir , fq.50

e “dytë”. Aristoteli për femrën thoshte së është “lëndë pasive, mashkulli është parimi që jep forcë, gjallëri, që jep jetë”. De Buvuar kujton se edhe Hipokrati fliste për dy lloje farëzash “Një e dobët, nga femra dhe një e fortë, mashkulli”. Historikisht, feminizmi liberal ka një paralelizëm të zhvillimit të tezave liberale me filozofinë liberaliste, sepse mendimi liberal politik para feminizmit është munduar ta ngre zërin e feminizmit liberal. Që në shekullin XVIII feministët liberal kërkonin që femra të barazohej me meshkujt, pasi që edhe ajo ka të drejtat natyrore¹⁴

Në shekullin XIX, feministët liberal kërkonin të drejtën e votës për femrat, të drejtën e pronës dhe barazi para ligjit për të dy sekset. Mendimtarët vërejnë se raportet burrë-grua janë prishur në dëm të femrës, në periudhën e industrializimit, kur punët në industri u bënë “punë meshkujsh”, ndërsa ato të shtëpisë, fëmijët, higjiena, ushqimet, etj, mbeten “punë femrash”. Në këtë raport edhe u bë dallimi esencial (burrat paguheshin për punën e bërë, ndërsa gratë jo). Kështu fuqia ekonomike u bë “mollë shëri” për debalansin në raportin burrë-grua. Në këtë mënyrë shpërthyen pikëpamjet individualiste për të kërkuar të drejta të barabarta dhe që fillimisht kuptoheshin si pikëpamje radikaliste. Në shekullin XIX, feminizmi liberal kërkonte të drejta ekonomike, shanse të barabarta si për meshkujt, ashtu edhe për femra. Dallimet ishin drastike edhe në mënyrën e pagesës, femrat për të njëjtën punë që bënin sikur edhe meshkujt paguheshin 50%, në vende urbane, ndërsa në vende rurale edhe më pak. Ky ishte një diskriminim i llojit të vet. Feministët liberal, duke parë se “lufta “ nuk solli asnjë fitore (për gratë) vendosën që të orientohen në kërkesa për të drejta politike. Kështu filloi “lufta“ për të drejtën e votës. Kjo “luftë “ u fitua në Angli, në vitin 1918 kur gratë e moshës 30 vjeçare mund të votonin , kjo u përhap shpejt edhe në vendet tjera, fillimisht në SHBA dhe gjetkë. Ndër veçoritë e mendimit liberal, vendin e parë themelor e zë individualizmi për faktin se esenca e mendimit liberal është pikërisht individi (individi racional)¹⁵

¹⁴ Seksi i dytë , Simone de Buvuar , fq. 28

¹⁵ Zekija Demir, “Feminizmi modern dhe Postmodern” fq. 46

2.5. Feminizmi në kontekstin e shkollimit

Sa l takon feminizmit të parë në aspektin e përfshirjes së grave në institucionet arsimore, sociologu Astrida Neimanis identifikon tre qasje (këndvështrime) të ndryshme feministe: **qasja liberale, socialiste dhe radikale** (Neimanis, 2001). Sipas këndvështrimit liberal, arsimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve të individit. Pra grave dhe vajzave duhet t'u mundësohet qasje e barabartë në arsim si dhe mundësi të barabarta në shfrytëzimin e asaj çfarë ofron arsimi. Në fokus të qasjes socialiste është eliminimi i padrejtësive sociale, klasore dhe gjinore dhe, sipas saj shkollat janë parë si mbështetëse të status quo-së dhe transmetimit të pabarazive ekzistuese. Në këtë aspekt, kjo perspektive sugjeron ndërhyrjen në mënyrat përmes të cilave arsimi i përforcon këto padrejtësi si dhe metodat që duhet të zbatohen për t'i ndryshuar ato. Feminizmi radikal fokusohet në reformimin e marrëdhënieve të pushtetit midis djemve dhe vajzave në klasë, ku pranohet fakti se, djemtë dominojnë në klasë ndërsa vajzat në këtë rast dëmtohen. Në mënyrë të ngjashme, programet përgjithësisht plotësojnë ose vënë në punë interesat e djemve dhe është vënë re se mësuesit favorizojnë më tepër djemtë sesa vajzat. Një problem tjetër janë ngacmimet seksuale të vajzave nga ana e studentëve dhe mësuesve meshkuj.

Studiuesit feministë në perëndim kanë qenë veçanërisht të interesuar të mbanin një qëndrim pozitiv ndaj barazisë gjinore në arsim. Feminizmi këtu përkufizohet si përkushtimi ndaj barazisë politike, sociale dhe ekonomike të grave duke i dhënë jetë shumë lëvizjeve, teorive, shkollave të mendimit dhe fushatave të ndryshme ndërgjegjësuere. Tre janë valët kryesore të historisë së mendimit feminist.

Vala e parë: shënohet në fundt të shekullit XIX dhe fillimi të shekullit XX dhe ishte e fokusuar në sigurimin e të drejtave të grave për të qenë pjesë e jetës publike, aspekteve politike, ekonomike dhe sociale të saj që deri atëherë kishin qenë të mohuara për to. Debati lindi kryesisht në shtresat borgjeze edhe pse me kalimin e kohës dhe shtrirjen në më shumë vende, shumë grupe u bënë pjesë e kësaj lëvizjeje për të fituar të drejtën e votës, të mirëqenies sociale dhe të drejtën për arsimim.

Vala e dytë: fillon në vitet '60-'70-të, vazhdoi përpjekjet për më shumë të drejta dhe barazi, por pa lënë mënjanë aspektet sociale që ndikonin drejtpërsëdrejtë në jetën e grave, p.sh., riprodhimi, seksualiteti, punët shtëpiake, dhuna në familje dhe kushtet e punës. Tre ishin aspektet mbi të cilat feministet ndërtuan lëvizjen e tyre; aspekti politik që bazohej tek përmirësimi i kushteve dhe i shanseve më të mira për vajzat dhe gratë; qasja kritike që synonte t'u kundërpërgjigjej formave dominuese sociale përgjithësisht të ndërtuara në bazë

të modelit mashkullor; dhe e fundit qasja praktike që synonte përmirësimin e kushteve profesionale dhe personale drejt një sistemi më etik dhe efektiv. Feministët u mbështetën fort tek këto tre elemente për të identifikuar nivelin akademik të vajzave dhe djemve, duke u ndalur veçanërisht te lëndët shkencore si matematika, zgjedhjet e tyre për karrierën dhe metodat pedagogjike që mund të përdoren për të promovuar barazinë. Megjithatë ishte e vështirë të arrihe në një konsensus se çfarë do të thoshte të ishe “një vajzë” ose “grua” duke qenë se faktorë të shumtë socialë, si: klasa shoqërore dhe etnia, kishin ndikim thelbësor në shanset dhe eksperiencat e këtyre grave.

Vala e tretë: daton pas viteve 1990 e në vazhdim, duke sjellë në vëmendje një gjeneratë të re studiuesish të kësaj fushe (kryesisht gra, por edhe disa burra), të cilët të mbështetur nga përpjekjet e nënave dhe gjysheve, identifikuan pikëpamjet e tyre. Kjo valë e tretë synon të jetë një feminizëm i ri që i përgjigjet rrethanave politike, ekonomike, teknologjike dhe kulturore që janë unike për dekadën që po jetojmë. Gjithashtu kjo vale refuzoi shumë nga konceptet e hershme të feminizmit, duke përvetësuar ide dhe vlera më koherente në favor të një aktivizimi më konkret social dhe politik të grave pavarësisht sanksioneve dëmtuese shoqërore. Duket sikur kjo valë e tretë e feminizmit është ngushtësisht e lidhur me teorinë dhe botën akademike më shumë se sa valët e tjera. Kjo ka ndodhur si rezultat i përfshirjes më të madh të grave në arsimin universitar dhe prezencës gjithmonë e në rritje të vajzave në auditorët universitarë, si një ambient ku diskutohen idetë dhe përjasjet teorike.

Studiuesit e kësaj gjenerate treguan më pak interes për nivelin e diferencuar të arritjeve akademike midis djemve dhe vajzave, sjelljeve apo roleve që ato përfitonin nga shoqëria, duke u bazuar më shumë tek mënyra se si nxënësit, studentët dhe mësuesit ndërtonin identitetin e tyre gjinor në lidhje me njëri-tjetrin. Pra në vend që të fokusohen te politikat makro- sociale, ato zgjedhin të analizojnë aspekte të ndryshme midis mikro-perspektivave dhe ndikimit kontekstual të barazisë gjinore në marrëdhëniet sociale. Skelton dhe Francis, thonë se vala e tretë nuk i jep prioritet ndryshimit të politikave në nivelin makro dhe për këtë arsye është pak e dobishme për politik-bërësit në fushën e arsimit. Ndërsa të tjerë, si Booth dhe Bennett mbështesin idenë se perspektiva gjinore është rezultat direkt i valës së tretë të feminizmit, duke kontribuar në zhvillimin e strategjive të barazisë gjinore.

Feminizmi evropian është një shembull shumë i mirë i ndikimit të specifikave gjeografike, historike dhe kulturore në zhvillimet e kësaj lëvizjeje. Vala e dytë e feminizmit lindi në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore me një konkretizim të mëtejshëm në Bashkimin Evropian. Riorganizimi i grupeve feministe pas luftës ishte më i vështirë për vendet të cilat njohën regjimet totalitare fashiste, si në Gjermani ose në Itali. Ndërkohë

vendet si Britania e Madhe, Amerika dhe Suedia, e kishin relativisht më të lehtë rigrupimin dhe riaktivizimin e këtyre grupeve. Historia kombëtare është një tjetër element që ndikon fuqishëm në këtë proces: p.sh., lëvizja feministe italiane ishte më rezistuese ndaj thirrjeve të përgjithshme të ndarjes së jetës publike sepse ato i gëzonin këto të drejta, deri në një fare mase, gjatë regjimit fashist. Lëvizjet feministe evropiane ishin një nga promotorët e ideve të reja për një politikë progresive, duke bashkëpunuar ngushtë me lëvizjen studentore të viteve 1960. Por, megjithatë, ato u treguan të kujdesshme për mbrojtjen e “hapësirës së tyre” dhe mbi të gjitha të kauzës së tyre, gjë që i veçoi ato paska nga rryma socialiste e kohës¹⁶

Edhe pse modeli amerikan i feminizmit ishte mbizotërues, pati një lulëzim të formave të reja në varësi të kulturës dhe politikave të vendeve ku ato linden dhe u zhvilluan. Ndërkohë në vendet e bllokut komunist lindor (deri në vitin 1989) kishte një mungesë totale të lëvizjeve feministe. Partia në fuqi, në saje të aparatit të saj kontrollues dhe formave të saj tashmë të vendosura të aktivizimit politik, e eliminoi një mundësi të tillë. Meqenëse barazia gjinore ishte një nga shtyllat themelore të shteteve komuniste, gratë edhe pse mund të arsimoheshin dhe të punësoheshin, nuk kishin një rol dominues ose me influencë në sferën publike siç edhe pritej¹⁷ Pas rënies së këtyre regjimeve, shanset e grave për një aktivizim më të madh në politikë dhe në jetën publike u rritën së tepërmi, por gjithmonë në bazë të vlerave dhe normave të kulturave specifike. Retorika dominuese e regjimeve komuniste ishte fajtorë për këtë situatë që u krijua pas rënies së këtyre regjimeve; për vite me radhë kishte krijuar një ideologji boshe që e bënte të pamundur përmbushjen e kritereve të një entiteti të ri politik që ishte Bashkimi Evropian. Për këtë arsye, shumë studime të ndërmarra në këto vende gjithnjë e më shumë e vendosin theksin te politikat e barazisë gjinore dhe janë vazhdimisht kritikë ndaj reformave të ndërmarra deri tani në sistemin e edukimit sepse e kanë lënë mënjanë një çështje të tillë.

¹⁶ Joni Lovenduski, “Gendering Politics, Feminising Political Science”, fq. 72, ECPR Press 2015

¹⁷ Po aty

2.6. Nga përpjekja për barazi deri te integrimi

Për të pasur më të qartë fenomenin e pabarazive, duhet vështruar konteksti historik i evoluimit të pikëpamjeve të barazisë në sferën e arsimit. Është e rëndësishme të nënvizohet se barazia (equality) si qëllim (objektiv) i sistemit arsimor paraqitet kryesisht me zhvillimet e shekullit të XX. Para kësaj periudhe, arsimit perceptohej si mjet për përgatitjeje e grupeve të ndryshme të njerëzve që do të kryenin detyra të caktuara në shoqëri apo do të mbanin pozicione sociale për të cilat kishte nevojë shoqëria (udhëheqës, luftëtarë, burokratë, punëtorë, nëna dhe shtëpiake). Vetëm në shekullin XX, sipas Eëndy Eëood filluan të shfaqen qartazi interpretime të ndryshme mbi konceptin e barazisë: Edhe atë duke u bazuar në: a). *shanset e barabarta për të jetuar*; b). *konkurrencën e hapur dhe e ndershme*; c). *kultivimin e barabartë të kapaciteteve të ndryshme* dhe ç). *arritje akademike pavarësisht klasës sociale*¹⁸.

Tanimë, në shekullin XXI koncepti i përfaqësimit të barabartë ka evoluar në konceptin e integrimi. Edhe në sistemin arsimor, gjithnjë e më tepër flitet për integrim gjinor, si formë për arritjen e barazisë sa më të plotë mes vajzave dhe djemve. Daniela Kalaja, në dezertacionin e doktoraturës “Përjasje të krahasueshme...” mes tjerash verën se shkollat që punojnë për barazinë gjinore, synojnë të ndryshojnë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të djemve dhe të vajzave, me qëllim që të zhduken paragjykimet dhe praktikrat zakonore, të cilat mbështeten në idenë e inferioritetit ose të epërsisë së njëjës gjini, apo në rolin stereotip të burrave dhe të grave. Duke punuar në këto fusha, në shkolla sigurohet parimi i barazisë, i mos diskriminimit dhe i rolit të shtetit në mbrojtjen e të drejtave të dy seksëve. Në shkollat që punojnë për barazinë gjinore synohet socializmi i djemve dhe i vajzave jashtë përgjithësimeve, skemave për cilësitë dhe karakteristikat e personalitetit, roleve profesionale dhe sociale që konsiderohen si tipike për meshkujt dhe femrat¹⁹. Konceptet e barazisë janë të përcaktuara nga përjasja kulturore.

Në Suedi, një nga vendet avangarde në respektimin e të drejtave gjinore, fjala *jämställdhet*, që do të thotë në pozita të barabarta, është kthyer në një koncept me rëndësi të veçantë. Ajo u shfaq për herë të parë në vitet 1970 dhe nënkuptonte një kontratë që siguronte një marrëdhënie më të barabartë midis burrave dhe grave, ndërsa u bë e pranueshme nga një pjesë e popullatës sepse kishte një kuptim vizionar dhe jo kërcënues. Nëse i referohemi terminologjisë politike, qëllimi kryesor i përdorimit të kësaj fjale ishte

¹⁸ Daniela Kalaja, dis “Përjasje të krahasuara...”, Tiranë, 2013, fq.15

¹⁹ Po aty, fq. 17

sigurimi i të drejtave të barabarta midis grave dhe burrave dhe ndarjes së përgjegjësisë dhe mundësive në proporcion të barabartë midis dy gjinive.

Pas viteve 1970 ky parim u zbatua në çdo aktivitet politik, ekonomik, social apo edukativ dhe u pasurua më shumë pas 1990, duke përfshirë edhe mbrojtjen e grave nga dhuna ose format e tjera të abuzimit, të cilat cilësoheshin si tregues të pabarazisë gjinore. Në bazë të kategorizimeve të mësipërme mund të thuhet se koncepti në pozita të barabarta ka pasur një rol të rëndësishëm në sigurimin e mundësive formale të barabarta, për inkurajimin e ndryshimeve social-kulturore dhe zbatimin e politikave të barazisë në sistemin qeverisës suedez. Termi “barazi” është kundërshtuar deri në një farë mase sidomos kur i referohemi interpretimeve të barazisë gjinore dhe formave të saj.

Sipas UNESCO ka shumë pak ndryshim midis termave equality dhe equity. **Barazi gjinore, (Gender equality)** i referohet të gjithë qenieve njerëzore pavarësisht gjinisë, të cilët janë të lirë të zhvillohen sipas aftësive të tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje të pandikuara nga stereotipat, rolet strikte gjinore dhe paragjykimet. **Drejtësi gjinore (gender equity)** i referohet trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në bazë të nevojave të tyre. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë ose të ndryshëm, por që është ekuivalent në terma të të drejtave themelore, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive²⁰.

Ka interpretime, sipas të cilave *Gender equality* nisët nga premisa se të gjithë studentët duhet të kenë shanse të barabarta në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë, përderisa përkufizimi i tyre për *Gender equity* implikon garantimin e rezultateve të drejta në edukim pavarësisht dallimeve gjinore. Koncepti i pabarazisë gjinore është lakuar shumë vitet e fundit, duke u parë në kontestin e performancave të provimeve/testimeve të nxënësve. Pra, analizohen përqindjet e vajzave dhe djemve që studiojnë dhe i kalojnë lëndët specifike për të arritur në konkluzionet se pabarazia varion nga njëra lëndë në tjetrën. Për këtë arsye, politikat gjinore synojnë uljen e kësaj pabarazie dhe rezultatet janë të dukshme. Megjithatë disa lëndë vazhdojnë të preferohen më shumë nga djemtë si p.sh. shkencat natyrore, teknologjia e të ngjashme, ndërsa lëndë të tjera, si p.sh. gjuhët e huaja apo lëndët tjera shoqërore preferohen më shumë nga vajzat.

²⁰ UNESCO 2000, fq. 5

2.7 Diskriminimi sipas gjinisë

Edhe pse janë të gjata përpjekjet për eliminimin e pabarazive gjinore, kur është në pyetje arsimi, njerëzimit i ka mbetur edhe shumë punë. Format janë të ndryshme duke nisur nga më brutale (ku vajzave u ndalohet të shkojnë në shkollë vetëm për shkak të përkatësisë së tyre gjinore) e deri te format e sofistikuara apo të tërthorta (që i bëjnë vajzat të tërhiqen me vetë dëshirë nga nivele të caktuara shkollimi, apo pozita drejtuese). Mentaliteti dhe mjedisi, janë padyshim faktorë të jashtëm të cilët determinojnë shkallën e pabarazive gjinore, por bota njih edhe shumë raste të përkeqësimit të situatës për shkak të luftërave, pushteteve diktatoriale dhe migrimëve.

Sipas Organizatës Human Rights Watch, rreth dy të tretat e vajzave në Afganistan nuk shkojnë në shkollë edhe pse zyrtarisht nuk janë në pushtetin e talebanëve. Pas rënies nga pushteti të talebanëve në vitin 2001 dhe fillimit të përpjekjeve ndërkombëtare për rikuperimin e Afganistanit, arsimi nisi të bëhet një nga prioritetet e qeverisë afgane dhe donatorëve të saj. Gjatë regjimit taleban, shumë pak vajza kanë mundur të studiojnë. Shumë prej tyre janë arsimuar fshehurazi në shkolla të paligjshme. HRW, raporton se qeveria afgane dhe donatorët e saj kanë arritur përparim të dukshëm në përpjekjet për arsimimin e vajzave, por megjithatë detyra nuk është përmbushur deri në fund. Konkretisht, siç deklaron Lizel Gernholz, drejtoreshë për çështjet e të drejtave të grave në këtë organizatë, "pasiguria, varfëria dhe zhvendosjet janë arsye që shumë vajza të mos shkojnë në shkollë". Përpjekjet e Kabulit dhe të donatorëve ndërkombëtarë për të shkolluar vajzat në Afganistan kanë dështuar në vitet e fundit, thotë organizata Human Rights Watch (HRW).

Raporti prej 132 faqesh thotë se përpjekjet për shkollimin e vajzave janë penguar për shkak të përkeqësimit të sigurisë dhe tërheqjes së donatorëve ndërkombëtarë. Raporti i titulluar "Unë nuk do të jem mjeke dhe një ditë do të sëmurem: Qasja e vajzave në shkollimin në Afganistan" bazohet në 249 intervista me vajza të moshës midis 11 dhe 18 vjeçe nga katër provinca. Më shumë vajza afgane ndjekin shkollimin sot sesa në kohën e talibanëve, por Qeveria e Afganistanit, e mbështetur nga Perëndimi, është larg arritjes së qëllimit për shkollimin e të gjithave, thuhet në raport. Sipas Qeverisë, 3.5 milionë fëmijë nuk shkojnë në shkollë dhe 85 për qind e tyre janë vajza. Vetëm 37 për qind e vajzave adoleshente dinë shkrim dhe lexim, krahasuar me 66 për qind të djemve adoleshentë. HRW thotë se pengesat më të cilat përbalën vajzat në Afganistan janë të shumta. Sipas organizatës, Kabuli siguron më pak shkolla për vajzat sesa për djemtë, si në nivelin fillor, ashtu edhe atë të mesëm.

Më pak se 20 për qind e mësimdhënësve janë gra, në më shumë se gjysmën e provincave të Afganistanit, çfarë, sipas HRË krijon barrierë për shumë vajza, të cilat nuk i lejojnë familjet të edukohen nga meshkujt. Shumë vajza detyrohen të qëndrojnë në shtëpi, për shkak të “qëndrimeve diskriminuese që nuk e vlerësojnë ose lejojnë shkollimin e tyre”, thekson HRË. Po sipas kësaj organizate, një e treta e vajzave në Afganistan martohen para moshës 18-vjeçare dhe kjo i detyron shumë të braktisin shkollën. HRË po ashtu vlerëson se, pavarësisht pengesave, shumë familje afgane po bëjnë gjithçka të mundur për t’i shkolluar vajzat e tyre. Organizata ka intervistuar familje që janë zhvendosur në qytet ose vend tjetër për të gjetur shkolla për vajzat e tyre. Po ashtu ka rastet kur vëllezërit e mëdhenj shkojnë në Iran, për të punuar ilegalisht, vetëm për të paguar shkollimin e motrave të tyre. Rreth një e katërta e fëmijëve afganë punojnë për të ndihmuar familjet e tyre. Shumë vajza thurin, qepin, kërkojnë lëmshë ose hedhin mbeturina në vend se të ndjekin mësimet²¹.

Të dhëna statistikore, thonë se 65 milionë vajza në gjithë botën nuk shkojnë në shkollë, ndërsa është alarmante edhe përqindja e femrave analfabete. Hulumtimet tregojnë se edukimi i femrave është i rëndësishëm edhe për arsye humane, pra se shkollimi i saj shpëton miliona jetë. Në një raport të publikuar nga “Huffington Post”, vlerësohet se “Nëse çdo femër përreth globit do të kishin të përfunduar shkollimin fillor dhe atë të mesëm, vdekjet e fëmijëve do të përgjysmoheshin, duke shpëtuar kështu 3 milionë njerëz”. Ndërkaq, po sipas tyre, një vajzë me tetë vjet shkollim ka gjasa katër herë më të vogla për t’u martuar si fëmijë dhe kjo me automatizëm do të ulte shkallën e analfabetizmit, të vdekjes së fëmijëve dhe do të përmirësonte gjasat për arsimim/punësim/mirëqenie/zhvillim. Sepse, sipas përlllogaritjeve të tyre, nëse një vajzë do të shkollohej plus një vit, si e rritur do të fitonte 20 për qind më shumë në pagë.

²¹ www.evropaelire.org/a/dy-e-treta-e-vajzave-afgane-nuk-shkollohen-/28799481.html



(Një vajzë shqiptare nga Kosova i përgjigjet një pyetjeje në orën e sociologjisë në shkollën e mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë, mars 2007)

Për të kremtuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsin, “HuffingtonPost” në vitin 2016 përzgjedhi 50 fotografi të vajzave që shkojnë në shkollë nëpër botë. Krahas vajzave të të gjitha moshave nga Kina, Palestina, Kenia, Anglia apo Pakistani, në njërin prej atyre fotografive ishin paraqitura edhe vajzat nga Kosova, si pjesë e tregimit se të gjithë fëmijët duhet ta kenë të drejtën për arsimim, pavarësisht gjinisë²².


²² <https://archive.koha.net/?id=7&l=102309>

2.8. Diskriminimi për shkak të orientimit

Në shumë vende të botës bëhen hulumtime për diskriminimin e nxënësve në shkollë edhe për shkak të orientimeve seksuale. Kështu në Shqipëri hulumtimi i Ambasadë PINK, i publikuar në vitin 2006 ka treguar se të rinjtë diskriminohen edhe për shkak të orientimeve seksuale. Studimi “Diskriminimi i adoleshentëve në shkollë për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, u realizua me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Shqipëri, ndërsa sjell të dhëna bazuar në perceptimin, përjetimin dhe gjykimin e nxënësve, sipas të cilave 34 për qind e adoleshentëve janë viktimat të diskriminimit në klasë, ndërsa 32 për qind në shkollë. Sakaq, 38 për qind e nxënësve kanë pohuar se adoleshentët diskriminohen (për të gjitha shkaqet) nga shoku/shoqja e klasës, ndërsa 25 për qind e tyre nga nxënësit në shkollë. Shkalla e adoleshentëve që diskriminohen në shkollë nga mësuesit e tyre është 15 për qind kurse e atyre që diskriminohen nga drejtori/drejtoresha e shkollës është 4 për qind. Nga ana tjetër 42 për qind e adoleshentëve vazhdojnë të ndjehen të diskriminuar herë pas here ose me të njëjtin intensitet si më parë.

Interesante janë gjetjet që kanë të bëjnë me qëndrimet dhe perceptimet që kanë adoleshentët për bashkëmoshatarët e tyre të komunitetit LGBT. 22 për qind thonë se në shkollën e tyre ka adoleshentë LGBT; 60 për qind kanë marrë vesh për orientimin seksual dhe identitetin gjinor të adoleshentëve të tjerë nga bisedat me shokët/shoqet e tyre, përderisa në 30 për qind të rasteve janë vetë adoleshentët LGBT që kanë folur në lidhje me orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor. Një pjesë e konsiderueshme, pra 20 për qind e adoleshentëve mendojnë se adoleshentët LGBT janë viktimat të dhunës homofobike dhe transfobike dhe 15 për qind mendojnë se adoleshentët janë LGBT vetëm sa për t'u dukur interesant. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 25 për qind deklarojnë se nuk i pranojnë dot adoleshentët LGBT në shkollë; 5 për qind se duhet të ndalohen që të ndjekin shkollën; 5 për qind se duhet të disiplinohen nga shkolla për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor; 10 për qind se adoleshentët LGBT janë të sëmurë dhe kanë nevojë për trajtim. 10 për qind kanë deklaruar se është e drejta e tyre ndërsa pjesa tjetër kanë thënë ose se nuk duan të komentojnë ose se nuk i intereson.

Figura nr.1



Pra, edhe pse një masë e konsiderueshme e nxënësve nuk duan të komentojnë dhe deklarojnë se nuk i intereson prezenca në shkollë e komunitetit LGBT (40 për qind bashkërisht) është po ashtu e madhe përqindja e atyre që kanë perceptime negative, që deklarojnë se: nuk i pranojnë, se duhet të ndalohen të vijnë në shkollë dhe se duhet të merren masa disiplinore. Vetëm 10 për qind janë ta hapu dhe thonë se është e drejta e tyre.

Ky studim është shtrirë në gjashtë Bashki të Shqipërisë (Tiranë, Korçë, Shkodër, Elbasan, Durrës dhe Vlorë) në një zonë që përmbledh thuhet dy të tretat e popullsisë së Shqipërisë, si urbane ashtu edhe rurale. U përfshinë në këtë studim 1443 nxënës nga tre shkolla të mesme në secilin prej gjashtë bashkive, me një mesatare të përafërt rreth 80 nxënës për çdo shkollë të vizituar nga ekipi ndihmës i studimit. Qëllimi i këtij studimi është të hedhë dritë mbi shkaqet e diskriminimit të adoleshentëve në shkollën e mesme të lartë publike me fokus të veçantë eksperiencat e diskriminimit të adoleshentëve LGBT.

Homofobia dhe paragjykimet seksuale, fatkeqësisht po shndërrohen në makthin e përditshëm të shumë nxënës LGBT. Për shembull, një studim i mbi 200.000 nxënësve në Kaliforni ka treguar se 7,5% e tyre ishin viktime të bulizmit vetëm sepse "ishin gay ose lezbike ose se dikush mendonte se (ata) ishin të tillë" Një grup i gjerë autorësh e konsiderojnë homofobinë si një ndër faktorët kryesorë të dhunës ndaj adoleshentëve në shkollë apo edhe përtej saj, sidomos për ata që perceptohen se kanë sjellje femërore për

meshkujt apo mashkullore për femrat. Këto perceptime shpesh shkaktojnë sjellje agresive dhe ndëshkuese ndaj viktimave. Studime të tjera janë fokusuar tek lidhja midis sjelljes seksuale apo asaj të perceptuar të adoleshentëve dhe orientimit seksual. Një studim me pjesëmarrjen e 194 adoleshentëve LGBT të moshës 15-21 vjeç gjeti se “shumica e të intervistuarve kishin pasur eksperiencë të viktimizimit dhe çdo mjedis social ku ata jetonin (komunitet, shkollë, lagje etj) paraqiste rrezik për të shkaktuar dëm ndaj tyre. Veçanërisht të rrezikuar nga abuzimi ishin të rinjtë që ishin vetë-evidentuar apo kishin deklaruar që në moshë të hershme seksualitetin e tyre apo ata që nuk mund ta fshihnin atë”.

Në Shqipëri, studimet shkencore për dhunën ndaj adoleshentëve LGBT janë inekzistente. Studimet e pakta shkencore mbi dhunën ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve tregojnë se “format më të shpeshta të dhunës fizike në shtëpi dhe në shkollë janë ato me goditje dhe përkatësisht: një në dy fëmijë goditen në kokë dhe trup në shtëpi, ndërsa një në tre goditen edhe në shkollë. Kjo do të thotë se në shtëpi fëmijët përjetojnë më shumë akte të dhunës fizike sesa në shkollë. Rezultatet e studimit të treguan se të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve (11, 13, 16 vjeç) ishin gjerësisht të përhapura. Thuajse 11 për qind e fëmijëve dhe adoleshentëve deklaruan se ishin ngacmuar seksualisht të paktën një herë në jetën e tyre, ndërsa thuajse 5 për qind e fëmijëve dhe adoleshentëve e konsideronin veten e tyre viktime të dhunës seksuale.

2.9. Vajzat më të goditura edhe nga bulizmi

Mungesa e tolerancës ndaj tjetrit dhe mos respektimi i dallimeve ka rritur shkallën e refuzimit deri në forma të dhunës agresive. I njohur me termin bulizimi, sjelljet e dëmshme dhe agresive në shkolla janë shëndërruar në fenomen botëror, ndërsa nuk mungon as në shkollat tona. Një raport i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë dhe Këshillit të Evropës, ka sjell gjetje të reja për shtrirjen e fenomenit edhe në mesin e nxënësve shqiptarë e ku më të rrezikuara janë vajzat.

Raporti në fjalë ka hetuar fenomen në një kampion prej 144 shkolla të Shqipërisë e, sipas të cilit bulizmi gjendet më shumë në shkollat private urbane dhe viktimat e tij janë më shumë vajzat, ndërsa agresorët janë gjithmonë djemtë. “19.4 për qind e nxënësve pohojnë se janë të buluar. Ky është fenomen që ndodh 3 deri në 2 herë në muaj. 9.7 për qind janë viktimat dhe 5.2 për qind agresorë. Vajzat pohojnë se janë më të buluara, djemtë janë ata që quhen agresorë. Fenomeni i përhapur më shumë në shkollat urbane dhe më shumë në shkollat private”, ka komentuar Tatjana Vuçani, specialiste e Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Bullizimi në shkolla shfaqet në disa mënyra, si bullizëm psikologjik, fizik, por edhe verbal, veçanërisht për shkak të paraqitjes së jashtme, si për shembull nga mbipesha, mbajtja e syzeve, etj. “Më të përhapurat janë ai psikologjik dhe ai për shkak të pamjes së jashtme. 45 për qind bullizëm psikologjik, 33 për qind bullizëm fizik, 37 për qind bullizëm verbal..”, ka thënë Tatjana Vuçani. Në studim evidentohet edhe bullizmi virtual ose kibernetike, pra tallja në rrjete sociale, më pak i përhapur, por gjithsesi i pranishëm për shkak të përdorimit masiv të facebook- ut apo instagramit.

Raporti pohon se prania e mësuesëve në klasë jo gjithmonë e frenon bullizmin dhe se ngacmimi vijon edhe në oborrin e shkollës. “Me mësuesit po bëhen trajnime të veçanta, janë hartuar modulet, që të fillojnë trajnimet e koordinatorëve”. Studimi rekomandon vëmendjen jo vetëm të mësuesit por edhe të prindërve në marrjen e masave të menjëhershme, për të evituar pasojat afatgjata të fëmijët dhe adoleshentët. Sepse, në bazë të gjetjeve 19.4 për qind e nxënësve e kanë provuar bullizmin 2-3 herë në muaj. Prej tyre, 9.7 për qind janë viktimat dhe 5.2 për qind agresorë.

Të analizuara sipas llojit 45 për qind e bullizmit është psikologjik, 33 për qind fizik dhe 37 për qind është bullizëm verbal. Ndërkaq, të analizuara sipas vendit: 39 për qind e

rasteve ndodhin në klasë, kur nuk është mësues(i)ja, 38 për qind në oborrin e shkollës dhe 13 për qind në klasë, në praninë e mësues(it)es.

III SHKOLLIMI MEKANIZVËM FUNDAMENTAL I ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË

3.1. Zhvillimi dhe rëndësia e shkollimit

Rëndësia e arsimit gjatë historisë njerëzore është e padiskutueshme sa i përket zhvillimit social dhe ekonomik të shoqërive edhe atë që në kohërat e lashta, kur nuk ka munguar kujdesi i mbretërive, perandorive dhe organizime tjera të lidhura me kohën. Madje edhe në shoqëritë primitive, ushtrimi i diturive mbi fenomene natyrore përbënte privilegj vetëm për prijësit e fiseve. Por me zhvillimin e shoqërive, vlera e dijeve filloi të rritet gjithë e më shumë dhe të vendoset në funksion të rendit shoqëror. Kështu nga antikiteti na janë të njohura Akademia e Platonit dhe Akademia e Arsitotelit, por fatkeqësisht fillet e institucioneve arsimore e kanë bazën në pabarazinë gjinore. Deri vonë, diskriminimi gjinor ishte i hapur dhe nuk përbënte asnjë problem. Pra jo vetëm në Spartë ku shkollat edhe ashtu ishin maskiliste (pasi kishin karakter kryesisht ushtarak), por edhe në Athinë e Romë ku shkollat kishin karakter shoqëror (Athina nxirrte filozofë, mjekë e matematikanë, ndërsa Roma nxirrte kryesisht politikanë e oratorë) shkolloheshin vetëm djemtë por jo edhe vajzat.

Në mesjetë, ndryshoi karakteri i shkollave. Edukimi i të rinjëve bëhej sipas mësimëve teologjike, filozofike, ligjore dhe etike të Kishës – për të krishterët apo në rastin e çifutëve sipas fesë hebraike dhe në rastin e myslimanëve sipas fesë islame. Përparësi iu dha përgatitjes së priftërinjve, rabinëve dhe imamëve²³. Por edhe në këto shkolla nuk kishte vend për vajza, ashtu sikurse nuk pati as në periudhën e Rilindjes evropiane, kur u shfaqën humanizmi, iluminizmi dhe sekularizmi – si element të cilët e gjallëruan shkollën nga errësira mesjetare.

Zhvillimi industrial - ekonomik dhe forcimi i klasës borgjeze krijoi një mentalitet të ri për jetën dhe punën, të cilat u reflektuan gjerësisht edhe në sistemin arsimor. U hapën licetë e para të vajzave në Angli dhe disa shtete të Evropës, të cilat sollën edhe emancipimin e shoqërisë.

Arsimi si proces shoqëror, gjithmonë ka shkaktuar interes të veçantë në hulumtimet e ndryshme teorike dhe empirike, debate shkencore profesionale dhe konferencat e ndryshme që kanë pasur për qëllim që sa më për së afërmi të caktohet vendi dhe roli i

²³ Shkollat fetare shërbyen si bazë për ngritjen e universiteteve të para sikurse ishin ato të Parisit, Bolonjës, Oxford-it dhe Cambridge-it. Ata u konsoliduan dhe u bënë qendra të dijes dhe të institucioneve moderne. Në vitin 1500 në Evropë numëroheshin rreth 80 universitete, të cilat e stabilizuan të mësuarit në shkollat dhe u bënë pararendëse të rilindjes evropiane

arsimit në shoqëri. Që të definohet shkolla si institucion do të duhet që sa më shpejtë të caktohet rëndësia e sociologjisë së arsimit si disiplinë sociologjike dhe të bëhet përcaktimi i objektit të saj të studimit²⁴. Për rolin dhe perceptimin e shkollës në shoqëri gjithmonë ka ekzistuar një interesim i madh. Ky interesim ka ndodhur edhe në bazë të asaj se shkolla gjithmonë ka pasur dhe ka domethënie të madhe në edukimin dhe arsimimin e gjeneratës së re²⁵.

Anthony Giddens, lidhur me organizmin e shkollës në dimensionin historik thotë se mund të bëhet periodizimi në tre periudha kryesore:

1. Periudha para industriale
2. Periudha industriale dhe
3. Sistemi modern i shkollimit

Megjithatë, sa i takon të drejtës së grave për shkollimi ajo që u nis me periudhën e dytë, industriale, u fuqizua dhe morri kuptim në periudhën e tretë, moderne.

Tranzicioni i viteve 90-ta të shekullit të kaluar e gjeti Ballkanin perëndimor dhe me theks të veçantë shtetet që dolën nga hapësira e ish-Jugosllave me një sistem të konsoliduar arsimor, pasi ishte zhvilluar relativisht mirë pas Luftës së Dytë Botërore. Nga mesi i shekullit XX shkollimi u bë i detyrueshëm prej moshës 6 ose 7 vjeç deri në moshën 14 ose 15 vjeç, në mënyrë të detyrueshme për djem dhe për vajza. Me këtë u zvogëlua dukshëm shkalla e analfabetizmit, por prapë se prapë ajo mbetej më e larët te gjinia femërore dhe te përkatësi të veçanta etno kulturore. Kështu, Instituti i Ekonomisë, në Zagreb, në vitin 2009 publikoi Raportin përmbledhës “Mbrojtja sociale dhe përjashtimi social në Ballkanin Perëndimor”, i cili u mbështet financiarisht nga Komisioni Evropian, më saktësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimin, Punës Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Por, “në periudhën e viteve ‘90 pavarësisht nevojës për modernizim, sistemet u përballën me një dekadë nën investimesh kronike, gjë që çoi në standarde më të ulëta, rritje të pabarazisë për sa i përket aksesit (pjesëmarrjes), si dhe një erozion në aksesin thuajse universal”, vëren Raporti.

Aty, gjen një vend të posaçëm edhe lufta, respektivisht konfliktet e armatosura si një burim i gjerë i krijimit të pabarazive në arsim. Me përhapjen e konflikteve etnike- nacionale, shkollimi u bë një fushë betejë ideologjike në pjesë të ndryshme të rajonit, gjë që u shoqërua me barriera në aksesin (qasjen) dhe zhvillimin e disa minoriteve dhe grupeve të tjera të

²⁴ Hasan Jashari, Sociologjia e Arsimit, Interlingua, Shkup, 2005, fq.33

²⁵ Po aty

cenueshme²⁶. Regjistrimi në sistemin parashkollor është i ulët në të gjithë rajonin sidomos në zonat rurale. Ndërsa niveli i shkollimit të detyrueshëm mbetet i lartë, përveç popullsisë rome, ka një shkallë të konsiderueshme të largimit nga shkolla në moshën 15 vjeç, në kohën kur i gjithë rajoni e ka në 50 për qind shkallën e regjistrimit në shkollë të moshës (15-18 vjeç) në përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës ku kjo masë është deri në nivelin e 15 përqindëshit. Gjithashtu, në arsimin e mesëm, ka diferenca të konsiderueshme midis zonave urbane dhe rurale dhe sipas të ardhurave të prindërve²⁷. Të gjitha raportet e Mbrojtjes Sociale dhe Përfshirjes Sociale nxjerrin në pah problemet për sa i përket infrastrukturës arsimore, motivimit të ulët të mësuesve dhe shkallë të larta të qarkullimit të tyre, si edhe nevojën që në disa qendra urbane shkollat të punojnë me dy apo me tre turne. Lidhur me Bosnjën theksohet problem i shkollimit të ndarë dhe segregacionit për grupet e ndryshme etnike.

Për sa i përket popullatës etnikisht të cenueshme, ka probleme me përcaktimin, mënyrat e vlerësimit, llogaritjes së numrave dhe sidomos të statusit juridiko-konstitucional të grupeve të ndryshme në vende të ndryshme të rajonit. Situata politike e grupeve etnikisht të cenueshme mbetet problematike në një pjesë të madhe të rajonit, ashtu siç është dhe situata e aksesit në arsim dhe tregun e punës. Varfëria, papunësia afat-gjatë, ndarja sociale dhe hapësinore, marginalizimi politik dhe social ndikon në të gjithë këto grupe, ndonëse me intensitet të ndryshueshëm. Arsimi dhe trajnimi përfaqësojnë një sfidë kyçe për politikën përfshirëse të qëndrueshme dhe efektive në vendet dhe territoret etnikisht të ndryshme të Ballkanin Perëndimor. Raportet e Institutit Evropian për Trajnime kanë identifikuar një numër temash të përbashkëta në të gjithë rajonin, që përfshijnë: mungesën e arimit parashkollor; kurrikulat e ndara në arsimin e përgjithshëm; probleme në respektimin e të drejtave për arsim në gjuhën amtare; kurrikula të shtrembëruara; shkollim i fragmentuar për disa grupe; stereotipa kulturore në trajnimin pa shkëputje nga puna dhe përgatitjen për punë; si edhe mungesa e mësuesve dhe drejtuesve minoritarë²⁸

²⁶ "Mbrojtja sociale dhe përjashtimi social në Ballkanin Perëndimor", Instituti i Ekonomisë, në Zagreb, 2009

²⁷ Po aty, pika 6

²⁸ Po aty, pika 7

Një pikë e veçantë në këtë studim i dedikohet popullsisë rome. Edhe pse në pjesë të ndryshme të rajonit kjo popullsi njihet si përfituese në masë e asistencave sociale, prapë se prapë janë pjesëmarrësit më të mëdhenj në aspektet ndëshkuese, sidomos në institucionet e riedukimit për të rinj. Deprivimet e shumëllojshme dhe diskriminimi tentojnë të përforcojnë njëra tjetrën nga pikëpamja e aksesit (qasjes) në qytetari, arsim, punësim, shëndetësi dhe siguri me rezultate negative për sa i përket rrezikut të varfërisë dhe përjashtimit social. Raportet tregojnë gjithashtu se Romët më të arsimuar përballen veçanërisht me vështirësi në gjetjen e punësimit sa që niveli deri ku arsimi i lartë e përmirëson perspektivën e punësimit është më i ulët për popullsinë rome, dhe shumë më i ulët për gratë rome.

Kur bëjmë analizën e shkallës së arsimimit të popullatës nuk mund të përjashtojmë as traditën familjare. Kështu, një hulumtim i bërë në Kroaci para disa viteve tregon se ka një dallim të theksuar në nivelin e arsimit bazuar në traditën familjare. Kështu sipas këtyre të dhënave perspektivat për qasje në arsimin e lartë janë më të favorshme për nxënësit që vijnë nga familjet më të arsimuara. Konkretisht, 56 për qind e nxënësve vijnë nga familje ku të paktën njëri prind është shumë i arsimuar, 41 për qind nga familje ku të paktën një prind ka përfunduar shkollën e mesme dhe vetëm 3 për qind nga familje ku shkalla më e lartë e edukimit të prindërve është shkolla fillore. Nxënësit e prindërve me arsim të dobët (prindërit e të cilëve kanë përfunduar arsimin fillor ose të mesëm si niveli më i lartë i arsimit) kryesisht regjistrohen në shkolla profesionale publike, në arsimin e lartë publik dhe në shkolla politeknike. Ndërkaq, fëmijët e prindërve me arsim të lartë mësojnë kryesisht në institucione arsimore të kategorizuara më lartë, sikurse janë atje universitetet publike dhe private²⁹

²⁹ Institut za razvoj obrazovanja", Eurostudent V, Nacionalno Izvješće Istraživanja za Hrvatsku, Zagreb, 2014

3.2. Shkolla vendi i pabarazive

Në institucionet arsimore, përveç pabarazive (diskriminimeve) gjinore janë të pranishme pabarazi që burimin e kanë në përkatësinë etnike, gjuhësore, kulturore, politike dhe sociale. Kështu, në shtete që llogariten si homogjene, nxënësit që i takojnë një gjuhë dhe një kulturë të caktuar, gëzojnë më pak të drejta se ato që i takojnë shumicës. Në shtetet heterogjene, si Serbia pjesë juridike e së cilës është Lugina e Preshevës, diskriminimi është i hapur dhe lidhet me politikën e pabarabarta që krijohen në sferën e arsimit (në rastin e këtij punimi) edhe atë duke nisur nga oferta. Konkretisht, nga mundësitë e limituara për vijimin e shkollimit prej njërit nivel në tjetrin, për të vazhduar më pas me mungesën e investimeve kapitale dhe të resurseve njerëzore, apo edhe me mungesën e teksteve shkollore, laboratorëve, teknologjisë informatike dhe pajisjeve tjera për zhvillimin e mësimi. Të gjitha këto mungesa bëhen shkaktarë për shkollim jo cilësor, pra suksese më të dobëta në mësim krahasuar me moshatarët e tyre, që mësojnë në kushte më të mira. Kjo, në të njëjtën kohë mban të frenuar mundësitë për ndryshimin e situatës, respektivisht për hapje të mundësive për shkollim.

Në shtete, me numër të lartë të emigrantëve, si Amerika për shembull, pabarazia etnike është analizuar dhe konstatuar në mesin e emigrantëve edhe atë duke krahasuar rezultatet e shkollimit të gjeneratave të parë, apo brezi 1.0 – siç quhen emigrantët e ardhur fëmijë dhe të gjeneratave të radhës, apo brezi 1.5 – siç quhen fëmijët e emigrantëve të lindur në vendin mikpritës. Këta të dytë, tregojnë rezultate më të mira se të parët (edhe pse i takojnë të njëjtit komunitet) dhe këtë fakt studiuesit e shpjegojnë me motivimin më të madh të brezit 1.5 për të qenë pjesë e shoqërisë së përbashkët. Pra, për dallim prej të tjerëve të tyre (brezi 1.0) fëmijët (brezi 1.5) synon integrimin në shtetin ku kanë migruar prindërit. Kjo i bën të jenë shumë më kërkues se prindërit e tyre. Por pavarësisht kësaj, ajo që i ve në pozita të pabarabarta emigrantët, si të ardhur ashtu edhe të lindur në vendin mikpritës është pabarazia gjuhësore, kuptohet si barrierë shumë më e madhe për të parët (1.0) dhe më pak për të dytë (1.5).

Ndodh shpesh herë që emigrantë të së njëjtës gjuhë të kenë performancë të ndryshme shkollimi. Pra pavarësisht barrierës së përbashkët gjuhësore, zhvillimi i tyre dhe integrimi në shtetin mikpritës dallon shumë nga njëri grup etnik te grupi tjetër. Të gjithë, flasin të njëjtën gjuhë brenda komuniteteve të tyre, por integrohen me intensitet të ndryshëm. Ka komunitet që janë të mbyllura dhe këta përveç se janë më refuzues ndaj integritimit/asimilimit janë edhe modest në pritjet e veta. Pra mjaftohen të gjejnë një punë të rëndomtë, sa për të

siguruar mirëqenien dhe nuk kanë ambicie për karrierë në shtetin ku janë vendosur. Madje, pjesa dërmuese e tyre ushqejnë ëndrrën që një ditë të kthehen në atdhe.

Dallimet sociale, janë gjithashtu një burim i vazhdueshëm i pabarazive në arsim. Sa më urbane të jenë mjediset shkollore aq më cilësor është arsimimi dhe e kundërta sa më të thella të jenë zonat aq më pak cilësore janë shkollat. Kjo lidhet me një sërë faktorësh:

- a) interesimi i shtetit për të investuar në këto shkolla është i vogël;
- b) kërkesat e nxënësve/prindërve janë modeste;
- c) mungojnë investitorët privat dhe sipërmarrësit;
- d) pritjet janë të vogla, e tj.

Madje, në zonat rurale është shumë më i pakualifikuar dhe më i pa trajnuar edhe kuadri mësimor, sepse kuadri i kualifikuar profesional në masë të madhe orientohet drejt shkollave urbane, atje ku ekzistojnë mundësi për krijimin e shkollave elite, kryesisht private dhe ku edhe pagesat e arsimtarëve janë më të larta.

3.3. Përfshirja në institucionet edukative – arsimore sipas gjinisë


Pabarazia gjinore është e pranishme në të gjithë sistemin arsimor, duke nis nga cikli i arsimit parashkollor, ku ka një dallim të madh në mes vajzave dhe djemve sa i përket përfshirjes në kopshte dhe çerdhe. Në nivel të Serbisë – pjesë e të cilës është edhe Lugina e Preshevës, Entit Shtetëror i Statistikave, tregon se dekadën e fundit ka një rritje të madhe të përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, por dallimet gjinore (mes përfshirjes së vajzave dhe djemve) vazhdojnë të jenë te thella. Konkretisht nga 179.865 sa ishte në total numri i fëmijëve të përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor në gjithë Serbinë për vitin 2010, gjashtë vite më vonë ai numër shkoi në 206.170 fëmijë³⁰. Pra në harkun kohor të shtatë viteve, është me se e dukshme rritja e numrit të fëmijëve të përfshirë në arsimin parashkollor, pasi në vitin 2016 kemi 26.305 fëmijë më shumë se sa në vitin 2012³¹. Por ajo që i bashkon të dyja ekstremet e kësaj periudhe progresive sa i takon përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, është dallimi mes përfshirjes së djemve dhe vajzave, në disfavor të këtyre të fundit. E njëjtë është situata edhe në vitet e ndërmjetme.

Statistikat në fjalë tregojnë se secilin vit, përqindja e vajzave është më e ulët se sa e djemve dhe pavarësisht tendencës për përfshirjen më të madhe të fëmijëve nëpër çerdhe dhe kopshte (dallimi nga viti 2012 në vitin 2016) kur është në pyetje raporti mes djemve dhe vajzave, situata mbetet e njëjtë. Figura numër 2, ilustron situatën në fjalë.

Figura nr. 2

³⁰ <http://www.stat.gov.rs/oblasti/obrazovanje/predskolsko-vaspitanje-i-obrazovanje>

³¹ Установе за децу предшколског узраста, број 99 - год. LXVII, 21.04.2017




(Shkalla e përfshirjes së djemve dhe vajzave në arsimin parashkollor 2010 – 2016)

Numri i nxënësve (femra) sikurse do të shohim më poshtë vazhdon të jetë më i ulët për disa shkallë krahasuar me numrin e nxënësve (meshkuj) edhe në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm, por jo edhe në nivelin e arsimit të lartë. Kështu nëse në shkollat e rregullta publike dhe private, të nivelit fillor dhe të mesëm kemi më shumë djem sesa vajza, nëpër universitet dhe shkolla të larta ku raport ndryshon në favor të femrave. Të dhënat statistikore, tregojnë gjithashtu se dallimi nuk është vetëm sasior (numerik) por edhe cilësor. Por le ti marrim numrat e përfaqësimit të djemve dhe vajzave me radhë, sipas niveleve të shkollimit.

Në arsimin fillor, gjatë katër viteve të fundit (nga viti shkollor 2014/2015 deri vitin shkollor 2017/2018) është shënuar në total një rënie prej gati 20 mijë nxënës, por raportet gjinore mbetet të fikse: 48.7 për qind femra si në vitin shkollor 2014/2015 ashtu edhe në vitin 2017/2018. Konkretisht nga gjithsej 558.869 filloristë të regjistruar në shtator të 2014-ës, 271.875 ose 48.7 për qind ishin femra. Vitin tjetër, nga 551.607 nxënës, 268.315 ose 48.6 për qind ishin femra. Një vit më vonë, nga 545.236 nxënës, 264.736 ose 48.6 për qind ishin

femra, ndërsa në shtator të vitit 2017 nga gjithsej 539.147 nxënës, 261.887 ose 48.7 për qind ishin femra³².

Figura nr. 3




(Shkalla e përfshirjes në arsimin fillor nga viti shkollor 2014/2015 deri në vitin 2017/2018)

Nëse i analizojmë raportet gjinore, pjesëmarrja e vajzave dhe djemve do të duket si në figurën me poshtë (nr.4)

Figura nr.4


³² Ученици основних школа по општинама, почетак 2014/2015; 2015/2016; 2016/2017; 2017/2018 школске године



(Raporti i nxënësve të shkollave fillore, sipas gjinisë në vitin shkollor 2017/2018)

Dallimet nisin e ngushtohen përafërsisht me një për qind, në nivelin e shkollës së mesme. Në harkun kohor prej vitit shkollor 2010/2011 deri në vitin shkollor 2017/2018 prezenca e nxënësve femra ngjitet në mesatarisht 49.5 për qind. Kështu nga 284.996 nxënës të cilët mësonin në shkollat e mesme të Serbisë, në vitin shkollor 2010/2011 nga 284.966 nxënës gjithsej, 141.675 (49.7 për qind) janë vajza kurse 143.291 (51.3 për qind) janë djem. Në këto proporcione është raporti gjinor i nxënësve të shkollave të mesme në vitet pasardhëse: në vitin shkollor 2014/2015 nga gjithsej 261.156 nxënës, 129.346 (49.5 për qind) janë vajza dhe 131.810 (51.5 për qind) janë djem; në vitin shkollor 2015/2016 nga gjithsej 253.997 nxënës, 125.557 (49.4 për qind) janë vajza dhe 128.440 (51.6 për qind) janë djem; në vitin shkollor 2016/2017, nga gjithsej 250.111 nxënës, 123.384 (49.3 për qind) janë vajza dhe 126.727 (51.7 për qind) janë djem dhe në vitin shkollor 2017/2018, nga 249.094 nxënës, 122.976 (49.4 për qind) janë vajza dhe 126.118 (51.6 për qind) janë djem.

Figura nr.5




(Shkalla e përfshirjes në arsimin e mesëm nga viti shkollor 2010/2011 deri në vitin 2017/2018)

3.4. Përmbysje e raporteve gjinore në arsimin universitar

Kur jemi te arsimi i lartë në nivel të shtetit, bie ne sy prezenca më e madhe vajzave se sa e djemve sidomos në shkollimin universitar. Në shkollat e larta profesionale, sidomos ato private dominojnë djemtë, mirëpo në universitet publike dhe private ka dukshëm me shumë vajza se sa djem. Nëse u referohemi të dhënave statistikore të vitit akademik 2017/2018 për numrin e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë del se nëpër universitete, si publike ashtu edhe private kryesojnë vajzat edhe atë me dallime të mëdha. Në universitetet shtetërore, prezenca e femrave është 59.1 për qind kundrejt 40.9 për qind të djemve (110.197 dhe 76.264). Në universitetet private hendeku bëhet ende më i thellë. Në vitin akademik 2017/2018, përqindja e femrave arrinte në 63.3 për qind, kundrejt përqindjes prej 36.7 të meshkujve.

Pra shkollimin universitar e ndjekin 28.221 femra dhe 14.320 meshkuj. Ndërkaq, në shkollat e larta si publike ashtu është private meshkujt kalojnë në avantazh sa i përket pjesëmarrjes, por me dallim aq të madh sa kishim rastin te universitetet. Këtu situata është pak më ndryshe. Në shkollat e larta publike përfshirja e femrave është 49.7 për qind kundrejt 50.3 për qind të meshkujve, pra gati se në mënyrë të barabartë. Në shkollat e larta private pjesëmarrja e femrave zbret në 43.8 për qind, kundrejt 56.2 për qind e meshkujve.

Figura nr.6



Shkalla e përfshirjes në institucionet e arsimit të lartë me karakter publik dhe privat

Përfshirja më e madhe e djemve në shkollat e larta, shpjegohet me tendencën e meshkujve për të hyrë më shpjet në tregun e punës, gjë për të cilën edhe funksionojnë shkollat e larta profesionale.

Tabela nr.1

Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2017/2018					
	djem	%	vajza	%	
Përgjithësisht	256.172	111.301	(43.4)	144.871	(56.6)
Universitete shtetërore	186.461	76.264	(40.9)	110.197	(59.1)
Universitet private	42.541	14.320	(33.7)	28.221	(66.3)
Shkolla e lartë	18.763	(50.3)	18.505	(49.7)	

shtetërore 37.268		
Shkolla e lartë private 4.223	2.373 (56.2)	1.850 (43.8)

Me gjithë përfshirjen më të madhe të femrave në arsimin universitar, përsëri edhe brenda kësaj kategorie janë disa programe studimore të cilat bëjnë përjashtim nga përshkrimi i përgjithshëm. Kështu, në Universitetin e Mbrojtjes Popullore raporti femra/meshkuj është 1 me 2. Konkretisht në virin akademik 2017/2018 ishin 657 meshkuj dhe 327 vajza. Pra nga 984 studentë të këtij Universiteti përfaqësimi i vajzave nuk tejkalon 33.2 për qindëshin.

Kjo natyrisht se lidhet me botëkuptimet e shoqërisë për disa lloje të profesioneve si “të meshkujve” dhe disa të tjera si “të femrave”. Këta të fundit, sikurse tregojnë të dhënat statistikore për numrin e studentëve në nivel shteti, dominojnë Universitetin e rasteve me 63.8 për qind kundrejt 42.2 përqindëshit të meshkujve. Konkretisht, nga 2.668 që studionin artet, 1.703 janë femra dhe 965 meshkuj. Figurat më poshtë ilustrojnë situatën në fjalë.

Figura nr.7





Figura nr.8



3.5. Gratë më të interesuara për kualifikime në moshë të rritur

Gratë i gjejmë çdo herë e më të përfshira në sistemin arsimor edhe në kuadër të arsimit të të rriturve, apo asaj që njihet ndryshe si shkollimi i përjetshëm. Kështu, shkalla e pjesëmarrjes së të rriturve, qoftë në shkollimin e formimit formal apo joformal, në vitin 2016 është 19.8 për qind e popullatës nga 25 vite e lartë dhe, që është pak më e lartë se përfshirja e njëjtë e vitit 2011 (16.5 për qind), por ndjeshëm poshtë mesatares së shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të cilët kanë një shkallë përfshirje të popullatës në arsimin e përjetshëm prej 45.1 për qind.

Sa i takon shkollimit dhe trajnimit për një periudhën prej 12 muajsh, respektivisht kualifikimeve në moshë të rritur kryesojnë gratë me 21.4 për qind, për dallim prej burrave të cilët përfshihen me 18 për qind. Shkalla e pjesëmarrjes është më e larta në mesin e popullatës 25 - 34 vjeçare edhe atë me 29.2 për qind. Statistikat tregojnë gjithashtu se shkalla më e lartë e atyre që vijnë me plotësimin e shkollimit në moshën madhore janë sidomos gratë që kanë arsim të lartë, që janë të punësuara dhe që banojnë nëpër qytete. Pra tendenca e kualifikime pas moshës 25 vjeçare, ose pas kryerjes së fakultetit apo ndonjë shkolle të lartë profesionale, sikurse tregojnë statistikat është në nivele më të larta te popullata e gjinisë femërore. Kjo flet për ambicie më të theksuara të grave për karrierë arsimore dhe mbindërtim profesional e që padyshim se është një trend pozitiv sa i takon vetëdijesimit të kësaj popullate me rëndësinë e të mësuarit të përjetshëm.

Shkollimi formal dhe jo formal, i cili po përhapet me trende pozitive edhe në Ballkanit, viteve të fundit u ka shërbyer shteteve gjegjëse për kualifikimin me kuadro për të cilat ka mungesa dhe në të njëjtën nevojë edhe tregu i punës.

IV SHKOLLIMI NË LUGINËN E PRESHEVËS, BUJANOVCI DHE MEDVEGJËS

4.1 Historia e shkollimit, vajzat që në “Iptidaie“

Në shkurt të 2018-ës, u mbushën 73 nga hapja e shkollës së parë shqipe në Preshevë, e cila nisi punën menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Për arsye të njohura historike e që lidhen me pushtimet e njëpasnjëshme që nga sundimi i Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë Serbe, deri në këtë kohë Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën apo Luginën në përgjithësi e karakterizonte prapambeturi arsimore. Një përqindje e lartë e popullatës ishte analfabete, ndërsa shkollimi i vajzave ishte në përqindje të vogla edhe atë me raste të rralla në ndonjë shkollë turke.

Gjuha në të cilën zhvillohej mësimi ishte padyshim një faktor determinues. Në shkollën e Bujanocit (1867) dhe Banjës së Sijarinës (1877) mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën serbe dhe prindërit nuk dëshironin ti dërgojnë aty edhe vajzat. Kështu ndodhi edhe në shkollat serbe që nisën të hapen nga viti 1914, ku gjithashtu në mesin e nxënësve mungonte elementi femëror.

Në periudhën 1890 – 1912 historia e arsimit në Luginën e Preshevës shënoi edhe rastet e hapjes së shkollave turke. Të dhënat e vitit 1892 flasin se në Preshevë në të ashtuquajturat “Ruzhdie” kanë mësuar 51 nxënës, në “Iptidaie” 103 nxënës dhe në “Sibiane” 41 nxënës. Vetëm në “Iptadie” kishte nxënëse femra, konkretisht 32 nga 102 gjithsej. Kjo përfshirje e konsiderueshme (31.3%) flet për vetëdijesimin e masës për rëndësinë e shkollimit të femrave e që është ne frymën e rilindjes kombëtare. Deri më vitin 1945, në Preshevë numëroheshin gjashtë shkolla filllore, katër klasë-she me rreth 150 nxënës. Edhe pse popullata ishte shumicë shqiptare, mësimi zhvillohej në gjuhën serbe, ndërsa ishin të punësuar 7 punëtorë arsimorë.

Si në të gjitha viset shqiptare, duke përfshirë këtu edhe komunën e Preshevës zhvillimin e arsimit e kanë shoqëruan kushte specifike, në krahasim me viset tjera të ish-Jugosllavisë. Pra, edhe zhvillimi i arsimit në komunën e Preshevës hasi në pengesa të mëdha, të cilat ishin të natyrës ekonomike, politike, mungesës së kuadrit arsimor, por mbi të gjitha edhe të prapambetjes arsimore e kulturore të trashëguara nga e kaluara si pasojë e një politike diskriminuese të pushtetit të atëhershëm jugosllav³³.

³³ Ilir Zylfiu, Arsimi Shqip në Luginë të Preshevës gjatë shek XX, Institui Albanologjik, Prishtinë, f. 202

Shkolla e parë në gjuhën shqipe në tërë Luginë u hap më 7 shkurt të vitit 1945, në objektin “Vila Letafet”³⁴. Shkolla mbante emrin “Selami Ibrahimi”, kishte dy paralele me 32 nxënës. Mësuesit e parë ishin: Hilmi Qerimi, Abdullah Ukshini, Tajar Zylfiu i Elbasanit dhe Demirali Ramadani-Hoxha. Në këtë vit shkollor në komunën e Preshevës ishin 130 nxënës gjithsej, prej tyre 27 femra dhe 103 meshkuj. Dy ditë më parë, më 5 shkurt 1945, mësim në gjuhën shqipe kishte nis në fshatin Raincë, me mësuesin e parë Fehmi Salihu nga Përlepnica e Gjilanit dhe me preferimet e Abdullah Krashnicës³⁵. Angazhimi për hapjen e shkollave fillore u shtrinë në të gjitha vendbanimet e mëdha të Luginës, por përfshirja e nxënësve sidomos vajzave ishte e vogël.

Foto 2



“Vila Letafet”, ku në vitin 1945 u hap shkolla e parë shqip ne Preshevë, e cila mbante emrin “Selami Ibrahimi

³⁴ Pronë e patriotit Abdulla Haxhi Veliut, i cili e kishte emëruar villën me emrin e të bijës, Letafetes

³⁵ Sekretar i Komitetit të PK-së së Preshevës, njëri prej kontribuesve të hapjes së shkollave shqipe

Shkollimi i masave, ishte tanimë detyrim ligjor dhe e drejtë kushtetuese. Në nenin 37 të Kushtetutës së RFPJ-së, thuhej se shkollimi fillor ishte i detyrueshëm dhe pa pagesë dhe se shkollat dhe institucionet arsimore ishin të hapura për të gjitha shtresat popullore³⁶. Shkollat punonin në bazë të një dokumenti që mbante titullin "Drejtimit për punën e shkollave të pakicave kombëtare" të cilin e kishte nxjerrë Ministria e Arsimit të Federatës Jugosllave, në datën 10 gusht 1945.

Në vitin 1948/1949 nisi edhe hapja e klasave të pesta - si klasë e parë e "Gjimnazit të Ulët", e cila më vonë kthehet në shkollën e parë filllore tetëvjeçare. Në vitin shkollor 1962/63 u hapën edhe 4 shkolla të këtilla, në Miratoc, Caravajkë, Raincë dhe Strezoc dhe më pas edhe në në Leran dhe Corroticë. Në Bujanoc hapen shkollat në Tërnoc, Bilaç, Lluçan, Muhoc dhe Zarbincë, ndërsa në Medvegjë, në Sijarinë dhe Tupallë. Një kontribut në shkollimin e popullatës ka pasur edhe Medreseja e Preshevës, e cila punoi deri në vitin 1947. Këtu jepte mësim njëri prej pishtarëve të arsimit shqip, preshevari Hafëz Alia³⁷, i cili kishte shërbyer dy herë si drejtor në Normalen e Prizrenit.

Në mungesë të kuadrit vendas, një kontribut të madh kanë dhënë mësuesit e ardhur nga qytete të Shqipërisë (Elbasan, Shkodër), Kosovës (Peja, Istogu, Vushtrria, Mitovica, Kamenica, Rogoçica) dhe Maqedonia (Struga), si dhe hoxhallarët të cilët mbështetën shkollimin në gjuhën amtare. Nuk munguan as mësueset femra, të cilat dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në emancipimin e femrës shqiptare. Mësueset e para kryesisht vinin nga viset tjera: Anastasie Elshanaj (Pejë), Cicilie Gashi (Prishtinë), Ilmie Turbetari (Prishtinë), Lara Stojku (Shkodër), Kadrije Qerimi (Preshevë), Mediha Karaxha dhe Mysherefe Mustafa (Mitrovicë), Nazmie Karaceva (Kamenicë), Sadie Limani (Pejë)³⁸.

Në studimet që pasqyrojnë kuadrin arsimor vendas bashkë me kualifikimet e tyre, gjithashtu vërtetohet raporti i thellë që ka ekzistuar mes mësimeve sa i takon gjinisë. Kështu, gjatë periudhës kohore 1945-1949, nga Presheva në shkollat fillore të Luginës së Preshevës ishin të angazhuar 18 mësues prej të cilëve vetëm njëra ishte femër (Kadrije Qerimi që kishte kryer kursin pedagogjik në vitin 1947 në Shkup). Ajo ishte njëra nga 18 mësuesit vendas që atë kohë vepronin në shkollat fillore të Luginës. Në vijim, lista me emrat dhe kualifikimet e secilit prej tyre³⁹

³⁶ Službeni list FNRJ, 10.02.1946 god.

³⁷ Ali Ahmeti (1856-1952)

³⁸ Tahir S. Berisha, Emrat që nuk harrohen, Prishtinë, 1994, fq.57

³⁹ Ilir Zylfiu, Zhvillimi i Arsimit Shqip në Komunën e Preshevës, Instituti Historik, Prishtinë, fq. 364.

Abedin Memeti – kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup,
Adem Memeti – kurs pedagogjik në vitin 1945,
Emin Ramadani – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Shkup,
Esat Ibrahim – 6 muaj kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup,
Fahredin Mustafa – kurs pedagogjik në vitin 1946, në Shkup,
Hilmi Qerimi – klasën e pestë të Shkollës Normale-Gjimnazi “Sami Frashëri” në vitin 1941/42, në Prishtinë dhe gjatë verës 1942 kursin pedagogjik në Prishtinë.
Hulusi Ibrahim – kurse Pedagogjike në vitin 1945/46, 1947, në Shkup.
Isa Selimi – kurs pedagogjik në vitin 1948, në Prizren, Gjakovë dhe Shkup.
***Kadrije Qerimi** – kurs pedagogjik në vitin 1947 në Shkup.
Memet Kadriu – kurs pedagogjik 1945/46, në Pejë.
Nevzad Jashari – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Prizren .
Nexhati Ramadani – kurse pedagogjike tre mujore 1945, 1946, 1947, në Shkup.
Ramiz Duraku – kurs pedagogjik në vitin 1948, në Shkup.
Rexhep Salihu – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Prizren e Pejë.
Sadri Ymeri – kurse të gjimnazit pedagogjik në vitin 1949, në Prizren.
Shukri Shaqiri – kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup.
Xhavit Limani – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Prizren.
Zejush Shabani – kurs pedagogjik 1945/46, në Pejë e Prizren

4.2 Zgjerimi i rrjetit arsimor dhe represioni politik

Avancimi i shkollimit në gjuhën shqipe në nivelin e arsimit të mesëm në Luginë nisi nga viti shkollor 1961/1962, kur në Preshevë u formuan paralelet në disperzuara të Gjimnazit “Bora Stankoviq” të Vranjës. 112 gjimnazistët e Preshevës ishin të shpërndarë në 3 paralele, ndërsa kishin 8 profesorë nga Vranja që mësimin e jepnin në gjuhën serbe dhe 4 mësimdhënës nga Presheva që mësimin e jepnin në gjuhën shqipe. Tre vite më vonë (1964/1965) paralelet e Preshevës u pavarësuan, ndërsa Gjimnazi mori emrin “Zora Socializma” për tu pagëzuar më vonë (në vitin 1968) me emrin “Skënderbeu”, të cilin e mban edhe sot.

Me vitin shkollor 1968/1969 lidhet edhe zanafilla e gjimnazit të sotëm të Bujanocit. Po këtë vit, Gjimnazi i Preshevës hapi paralelet e disperzuara në fshatin Tërnoc, të cilat u pavarësuan në vitin shkollor 1973/1974 në Gjimnaz i cili u transferua me punë në Bujanoc. Gjimnazi mori emrin e dëshmorit “Sezai Surroi” të cilin e mban edhe sot.

Në vitin shkollor 1989/1990 kur në ish-Jugosllavi nisi të zbatohet reforma arsimore, në Preshevë u themeluan edhe Shkolla e Mesme Teknike. Por, në këtë kohë vetëm se kishin nis aplikimi i masave të dhunshme të regjimit serb në shkollat e Luginës së Preshevës, duke përjashtuar nga puna kuadrin më të mirë mësimdhënës dhe duke lënë në margjinat e kujdesit institucional. Investimet për mirëmbajtjen e shkollave dhe modernizmi i arsimit nuk u ndjenë fare në këtë pjesë. Kjo politikë diskriminuese, edhe pse në forma shumë më të zbutura vazhdon të praktikohet edhe sot e kësaj dite.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Serbisë nuk angazhohet as për sigurimin e teksteve shkollore. Pas shumë protestave, peticioneve dhe kërkesave, mezi u arrit që të sigurohen 88 tekste për arsimin fillor. Arsimi i mesëm edhe më tej ka mungesa shumë të mëdha.

Në prag të fillimit të vitit shkollor 2014/2015, përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Luginën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës (KKSHL) iu drejtuan zyrtarisht Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Serbisë, që të lejojë përdorimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe për nxënësit e shkollave të mesme të botuara në Kosovë dhe Shqipëri, pasi nxënësit shqiptarë të Luginës mësojnë me materiale të përkthyer nga serbishtja dhe kryesisht me shënimet e diktuar nga ana e profesorëve. Galip Beqirit, kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar deklaronte se “falë angazhimit të përfaqësuesve të Komisionit për Arsim të Këshillit Kombëtar, deri më tani për shkollat fillore

janë siguruar mbi 70 për qind të teksteve, ndërkohë që pritet leja edhe për librat e shkollave të mesme, të cilat kërkojnë që sigurohen gjithashtu ose nga Shqipëria ose nga Kosova”.

Sipas Ligjit për arsimin fillor në Serbi të gjithë nxënësve iu shpërndahen librat falas nga klasa e parë deri në të katërtën, ndërkohë që nga kjo praktikë janë privuar nxënësit shqiptarë në Luginë të Preshevës. Çështja u sensibilizua deri në instancat e Parlamentit, kur në gusht të 2014-ës deputeti Shaip Kamberi e parashtrroi si problem që duhet zgjidhur institucionalisht. Në mars të 2016-ës, ministri i Arsimit, Srgjan Verbiq nënshkroi marrëveshje me përfaqësuesit e pakicave për sigurimin e mjeteve prej 134 milion dinarë për librat që u mungojnë nxënësve të Luginës, por problemi nuk është zgjidhur plotësisht. Më 18 shkurt të atij viti, një pjesë e spektrit politik shqiptar protestoi para terminalit doganor në Preshevë, ku u mbaheshin rreth 103 mijë libra nga Kosova të dedikuara nxënësit e shkollave fillore të Luginës⁴⁰.

Për fat të keq, problemet nuk përfundojnë me çështjen e librave. Mungesës së investimeve dhe kushteve elementare për mësim iu shtua edhe ajo e “tepricës teknologjike” të kuadrit arsimor. Kështu në listën e përgatitur nga MASHT në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2017/2018 u gjendën 447 punëtorë arsimorë, disa prej të cilëve mbetën pa punë për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve. Fenomeni i zvogëlimit të numri të nxënësve dhe paraqitjes së tepricës teknologjike, preku të gjitha shkollat shqipe, në mesin e të cilave edhe Gjimnazin “Skënderbeu” dhe Shkollën e mesme teknike në Preshevë, si dhe Gjimnazin “Sezai Surroi” në Bujanoc,

Nuk u kursyen as shkollat fillore të këtyre komunave si: “Selami Hallaçi”, “Dituria”, “9 Maji”, “Abdulla Krashnica”, “Zenel Hajdini”, “Muharrem Kadriu”, “Naim Frashëri”, “Migjeni” e disa të tjera. Kryetari i Trupit Koordinues të KKSHL-së, Zejni Fejzullahu e drejtor i Shkollës së Mesme “Sezai Surroi” në Bujanoc, disa vite pas marrëveshjes arsimore me mes të Serbisë dhe Shqipërisë, vazhdon të denonconte problemin e mungesës së teksteve mësimore në shkollat e Luginës. Sipas tij, për shkollën e mesme janë siguruar vetëm 4 tekste shkollore, për nxënësit nga viti i parë deri në të katërtin, ndërsa nevojiten mbi 300 tekste vetëm për lëndën e gjuhës amtare⁴¹

⁴⁰ <https://ilonline.com/keshilli-kombetar-shqiptar-ska-interesim-per-zgjidhjen-e-librave-shqip/>

⁴¹ <http://www.ekonomiaonline.com/globi/rajon/ne-lugine-te-presheves-viti-ri-shkollor-shume-probleme/>

4.3 Librat promotorë të pabarazisë gjinore

Pavarësisht nevojës së pakontestueshme të librit si mjet bazë i shkollimit, si dhe përpjekjeve të shqiptarëve të Luginës për të gjetur zgjidhje përmes sigurimit të librave nga Kosova dhe Shqipëria, nuk mund të anashkalohej problemi i pabarazive gjinore i cili është prezent pothuajse në secilin tekst mësimor dhe si i tillë përbën fundamentin e promovimit të pabarazisë mes meshkujve dhe femrave. Librat, që vijnë nga Kosova, u mësojnë nxënësve sesi gruaja duhet të jetë duke gatuar në kuzhinë, përderisa burri lexon gazetë. Pastaj babai, e jo nëna, është ai që u jep para fëmijëve, apo nëse çifti është në makinë, babai do të jetë drejtuesi i saj.

Madje shkohet edhe në konstatime të gabuara se gjoja pavarësia ekonomike e grave është një nxitës për shtimin e divorceve (libri i Edukatës Qytetare për klasa IX). Librat e shkollës, i paraqesin gratë kryesisht inferiore në raport me burrin dhe kjo sipas ekspertëve të arsimit kontribuon në ndërtimin e bindjes tek vajzat se “është normale” të kesh rol inferior në jetë, në raport me burrat. Kështu, Dukagjin Pupovci, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Arsim të Kosovës (QAK) thotë se një kohë të gjatë barazia gjinore në arsim është kuptuar si krijim i mundësive për vajzat që të vijojnë shkollimin, ndërsa shumë pak kujdes i është kushtuar përfaqësimit gjinor në tekste mësimore. Prandaj, në tekstet tona do ta gjeni gruan si inferiore në raport me burrin, vëren ai duke plotësuar se dhënia e shembujve se gruaja është ajo që duhet të gatujë në kuzhinë, përderisa burri lexon gazetë; apo se babai, e jo nëna, është ai që i jep para fëmijëve; ose nëse çifti është në makinë, babai do të jetë drejtuesi i saj, janë format e stigmatizimit të vajzave. Pra, shkolla i kontribuon ndërtimit të bindjes tek vajzat se do të kenë rol inferior në jetë, në raport me burrat. Kur kësaj, i shtohet edhe edukata familjare tradicionale, nuk është çudi që një numër i konsiderueshëm i burrave dhe grave e pranojnë pabarazinë gjinore si të mirëqenë.

Me realitete të këtilla është përballur gjithë njerëzimi gjatë zhvillimeve historike dhe shoqërore dhe kuptohet se gjendje të këtilla tejkalohen, gradualisht, përmes emancipimit të burrave dhe të grave. Kjo është arsyeja që, në mbarë botën, burrat janë shumë më të përfaqësuar në tekste të historisë sesa gratë dhe ky realitet mund të jetë i pranishëm edhe në të ardhmen, pasi edhe në kohën e sotme, në pothuaj se çdo vend të botës, prezenca e burrave në politikë është shumë më e madhe sesa prezenca e grave. Madje, burrat dominojnë edhe në biznes, në shkencë, e në jetën akademike. Pupovci, nënvizon se burrat dominojnë edhe në disa profesione që nuk ngërthejnë në vete asnjë lloj të ngarkesës fizike, siç është teknologjia e informacionit, ndërkohë që për gratë janë të “rezervuara” karrierat në

fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Do të duhen dekada që kjo gjendje të ndryshojë, megjithatë nuk duhet pushuar së punuari që ky ndryshim të arrihet⁴².

Pabarazia gjinore është konstatuar edhe në tekstet shkollore të botuara në Shqipëri, një pjesë e të cilave përdoren edhe në shkollat e Luginës. Ilustrimet me fotografi apo vizatime, sikurse dihet zënë një vend të rëndësishëm në tekstet shkollore duke i qartësuar dhe plotësuar përmbajtjet e tekstit, sepse arrijnë të komunikojnë drejtpërdrejtë me nxënësit dhe i bëjnë të mbajnë mend edhe më mirë mësimin. Por, ajo përcjellin tekstet shkollore në këtë drejtim nuk lë aspak për të dëshiruar. Kështu për shembull, në tezën e saj të doktoraturës, me titull “Prania e aspektit gjinor në kurrikulën e shkollës së mesme”, Marta Topçiu, vëren se në librin “Historia 10”, ka në total 216 ilustrime, prej të cilave 5 vetëm me vajza, 70 vetëm me meshkuj, 20 edhe femra edhe meshkuj dhe 121 nuk kanë të bëjnë në objektivin e studimit. Në librin “Gjuha shqipe dhe letërsia shqipe 10”, ka në total 278 ilustrime nga të cilat 47 paraqesin femra dhe 108 meshkuj. Meshkuj e femra gjejnë vend në 54 ilustrime, ndërsa 69 janë me ilustrime të ndryshme.

⁴² <http://zeri.info/aktuale/175893/tekstet-mesimore-nxisin-pabarazine-gjinore/>

4.4. Paragjykimet në ndarjen e roleve gjinore

Psikologët vënë theksin te pasojat dhe alarmojnë se “rolet gjinore i privojnë nxënësit nga mundësia e edukimit dhe përzgjedhjes së profesionit. Psikologja Pranvera Jetishi, thotë se në shumë materiale mësimore në mënyrë të dukshme, burrat i kalojnë gratë në përmbajtjen e librave shkollore. Burrat, sqaron ajo dominojnë situatat me tema të një aktiviteti të lartë si: më të zgjuar, më të guximshëm, më aventurier dhe më fitimtar. Ndërsa gratë paraqiten në situata të dorës së dytë si: më pasive, viktima dhe të varura, të urta, të brishta.

Studime të ndryshme, tregojnë një barazi gjinore sa i përket përfundimit të shkollës së mesme në mes burrave dhe grave, por kjo barazi bie në mënyrë drastike, siç shprehet ajo sa i përket shkollimit universitar dhe atij pas universitar. Jetishi, vlerëson se shkollat dhe materialet mësimore, shërbejnë si një forcë socializuese e fuqishme edhe në drejtim të roleve gjinore. Në bazë të kësaj, ajo thotë se gjithë këtij stereotipizimi seksual vërehet nevoja për rishkrim të materialeve mësimore duke bërë eliminimin e seksizmit. “Sepse, meqë rolet mësohen, gjithmonë ekziston mundësia që ato edhe të çmësohen, të definohen dhe ridefinohen. Për shkak se pasojat e roleve gjinore janë të shumta, në karrierën jetësore të individit, duke privuar nga mundësia e edukimit dhe përzgjedhjes së profesionit, ushtrimit të profesionit apo punësimit. Socializimi gjinor, vazhdon përgjatë gjithë jetës. Faktorë shumë të rëndësishëm në edukimin e përgjithshëm të fëmijëve e në veçanti edhe në edukimin gjinor janë fillimisht, prindërit, shkolla, mësuesit, materialet mësimore, kurrikulat, organizatat e ndryshme, media, besimi fetar dhe shumë faktorë të tjerë. Duke mos mohuar aspak rolin e secilit nga faktorët e lartpërmendur në edukimin e nxënësve, një rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet edukimit që fëmijët marrin nga shkolla dhe materialet mësimore”⁴³

Pra, çfarëdo ndikimi që të kenë prindërit apo anëtarët e tjerë të familjes për zhvillimin dhe edukimin e fëmijës, me të filluar shkolla, barra e përgjegjësisë i bie shkollës, pra mësuesve dhe materialeve mësimore. Sepse, është pikërisht pabarazia gjinore, apo caktimi i rolet gjinore ashtu sikurse i gjejmë në tekste shkollore, që kontribuojnë në krijimin e paragjykime gjatë edukimit të nxënësve. Aspekti diskriminues, duhet te mos gjejë hapësirë në tekstet shkollore. Personaliteti modern duhet të bart në vete një integritet të emancipuar të gjinisë që do reflektojë kujdes, respekt dhe vetëdije se asnjë gjini nuk mund të definohej pa respektin absolut dhe intergimin human mes njëra-tjetrës.

⁴³ Po aty

Sipas një hulumtimi të Qendrës për Arsim të Kosovës (QAK) lidhur me barazinë gjinore në librat e leximit në arsimin e detyruar nëntë vjeçar (me të cilat mësojnë edhe nxënësit e Luginës) rezultoi se ka një disbalanc të madh, sa i takon shkallën e përfaqësimit të roleve profesionale të burrave dhe grave. Hulumtimi në fjalë ka arritur në konstatimin se në shtojcat figurative, burrat janë dominues. Sepse në 187 tekste, në shtojca figurative paraqiten role profesionale të burrave, ndërsa rolet profesionale të grave paraqiten gjithsej në 96 tekste apo në 91 tekste më pak sesa burrat. Gratë, sikurse theksohet në këtë hulumtim janë në pozitë të diskriminuar edhe në rastet kur tekstet përcillen me interpretimin e përmbajtjeve të tekstit. Vetëm në 17 apo 3.5 për qind të teksteve me rastin e interpretimit flitet vetëm për gra, ndërsa në 60 apo 18.6 për qind flitet vetëm për burra.

4.5 Femrat drejtojnë dy nga 9 shkollat e Preshevës

Shkolla Fillore " Ibrahim Kelmendi" është njëra prej gjashtë shkollave fillore të Preshevës, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Me rreth 1500 nxënës dhe 145 mësimdhënës këtu organizohet mësim nga klasa e parë deri të tetën. Shkolla punon në dy ndërrime në kushte të rënda. Edhe pse është shkolla më e madhe shqipe në Preshevë ajo ka mbetur jashtë vëmendjes institucionale, si të Beogardit ashtu edhe të pushtetit vendor, për shkak të përplasjeve politike. Lëvizjet e popullatës shqiptare drejt shteteve të Evropës, kanë ndikuar në uljen e numrit të nxënësve. Kështu, nëse në përfundim të vitit shkollor 2015/2016 shkolla numëronte 1650 nxënës, dy vite më vonë ajo e nisi vitin shkollor me 1492 nxënës, pra me 185 nxënës më pak. Ka gjithashtu histori të shpeshta të ndërrimit të emrave. Për katër dekada (1965 – 2008) shkolla e ka ndërruar tre herë emrin. Pasi u themelua me emrin "18 nëntor" , u ri pagëyua "15 nëntori" për të marrë emrin e patriotit preshevar Ibrahim Kelmendit, në vitin 2008. Këtë emër mban edhe sot.

Shkolla prej vitesh drejtohet nga një femër. Ashtu si në shkollat tjera edhe këtu në mesin e të punësuarve dhe nxënësve dominon elementi femëror. Por ajo që e dallon nga shkollat tjera është se elementi femër dominon edhe në këshilli drejtues të shkollës. Gjinia femërore dominon edhe në numrin e përgjithshëm të kuadrit arsimor. Nga gjithsej 145 mësimdhënës, 80 janë gra dhe 65 burra.

Në vitin shkollor 2017/2018 në klasë të parë u regjistruan 165 nxënës (prej tyre 74 vajza dhe 91 djem), ndërsa në total numëronte 1.492 nxënës (prej tyre 731 vajza dhe 761 djem). Pra, sikurse mund të shihet edhe nga numrat e nxënësve, dominojnë djemtë dhe jo vajzat, mirëpo këto të fundit kanë nivel më të lartë të mesatres së notave (4.37) kundrejt mesatares të notave të djemve (3.89). Mesatarja e notave (suksesi) i nxënësve në nivel të shkollës është 4.13.

Ajo që bie në sy ka të bëjë me grupimin e nxënësve dhe mësuesve, sipas gjinisë. Në përgjithësi nxënësit ulen në bankë sipas modelit "vajzë me vajzë" dhe "djalë me djalë". Ndërsa gjatë kohës së pushimit mes orëve të mësimi, po sipas këtij modeli sillen në të shumtën e rasteve edhe mësimdhënësit. Situata përafërsisht e ngjashme është edhe në pesë shkollat tjera fillore me mësim në gjuhën shqipe sa i takon raportit gjinor të pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe sjelljeve të tyre. Por, kjo nuk ndodh, sa u takon posteve vendimmarrëse, si në shkollat fillore ashtu edhe të mesme.

Në Preshevë ka gjithsej 9 shkolla, prej të cilave 8 në gjuhën shqipe (gjashtë fillore dhe dy të mesme). Prej këtyre 9 shkollave vetëm 2 drejtohen nga femra, pra jo më 22 për

qind. Kjo sigurisht ka të bëjë me përcjelljen brez pas brezi të mentalitetit se në poste drejtorësh duhet të qëndrojnë burrat, kurse femrat duhet të mjaftohen me rolin e mësimdhënësve.

4.6. Drejtimet e “vajzave” dhe drejtimet e “djemve”

Ndarja e roleve sipas gjinisë duket se është shtresuar thellë në mentalitetin e shoqërisë shqiptare të Luginës dhe kjo ndikon në më së të madhe jo vetëm në profesionet që ato ushtojnë por edhe në zgjedhjet e “profesioneve të ardhshme”. Këtë sjellje shoqërore e gjejmë të reflektuar veçanërisht në nivelin e arsimit të mesëm dhe të lartë. Kështu, për shembull në Shkollën e Mesme Profesionale “Presheva” ka drejtime të cilat si me një ligj të pa shkruar u rezervohen vetëm djemve dhe të tjera drejtime që funksionojnë kryesisht me vajza.

Në këtë shkollë (e vetmja shkollë e mesme profesionale) krahas drejtimeve të profileve ekonomike dhe teknike, funksionojnë edhe paralelet e mjekësisë, të cilat dominohen nga vajzat. Në vitin shkollor 2017/2018, në paralelet e mjekësisë numërohen 720 nxënës, prej të cilëve 520 janë vajza dhe 200 djem.

Figura nr.9



Figura nr.10



Ndarja e nxënësve në këtë mënyrë, flet qartë se shoqëria udhëhiqet nga paragjykime sa i takon roleve të gjinive në disa lloj profesioneve, ku bën pjesë edhe kjo e infermierisë, respektivisht drejtimeve mjekësore nëpër shkolla të mesme. Një prej arsyeve që i orienton në masë më të madhe nxënësve femra në këtë lloj shkollimi (kur jemi te niveli i arsimit të mesëm) është mundësia e punësimit të tyre (vajzave) si ndihmëse infermiere dhe pozita të ngjashme nëpër spitalet shtetërore apo klinikat private. Pra, këtu i jepet fund arsimimit të


vajzave, ndërsa karriera profesionale (doktorë, specialistë, primarius) u takon kryesisht burrave.

Mirëpo, në ekstremin tjetër qëndrojnë paralelet e drejtimit teknik i përpunimit të drurit, ku të njëjtin vit shkollor (2017/2018) ishin të regjistruar 120 nxënës, që të gjithë djem. Pra prezenca e vajzave në këtë drejtim është zero. Kështu ka qenë vite me radhë dhe do të duhet të kalojnë edhe shumë kohë derisa shoqëria të ndyshojë qëndrimin sa i takon mos orientimit të vajzave në drejtime dhe profesione të caktuara.

Në drejtimet tjera: ekonomi, teknik dhe kompjuterizim dominojnë gjithashtu djem, por është e konsiderueshme edhe prezenca e vajzave. Konkretisht, në paralelet e ekonomisë nga gjithsej 400 nxënës 220 janë djem dhe 180 vajza. Në drejtimin kompjuterizim nga gjithsej 225 nxënës, 125 janë djem dhe 100 vajza. Në drejtimin teknik nga gjithsej 225 nxënës, 125 janë djem dhe 100 vajza. Kështu, nga numri i përgjithshëm i nxënësve për të gjitha drejtimet (1690) raporti gjinor është 865 djem dhe 825 vajza.

Sa i takon arsimimit nëpër gjimnaze, gjërat duket se ndryshojnë. Kjo, padyshim që ka të bëjë me perceptimin se gjimnazet janë shkolla që përgatisin studentë të ardhshëm, pra ata që do të regjistrohen nëpër fakultete (qofshin këta edhe të shkencave të mjekësisë apo teknikës) për dallim prej shkollave të mesme profesionale të cilat përgatisin kuadro të gatshëm për të punuar në zanate të ndryshme. Kështu në gjimnazin "Skënderbeu" në Preshevë ndarja e nxënësve sipas gjinisë nuk është aq e thellë. Vitin shkollor 2017/2018 në vit të parë u regjistruan 180 nxënës, prej tyre 91 vajza dhe 89 djem. Në këto raporte gjinore ka qenë regjistrimi edhe viteve të kaluara, për çka flet numri i përgjithshëm i nxënësve (nga viti i parë deri vitin e katërt). Në shtator të 2017-ës. Numri i përgjithshëm i nxënësve që ndiqnin mësimin në këtë gjimnaz ishte 900. Prej tyre 470 ishin vajza dhe 430 ishin djem, pra vija ndarëse mes vajzave dhe djemve është e ngushtë.

Fig.11



Një tregues tjetër që bën dallimin e shkollave të mesme, në kontekstin e raporteve gjinore është numri më i madh i të mësimit burra, për dallim prej shkollave fillore ku dominojnë mësimit gra. Konkretisht në Gjimnazin “Skënderbeu” ka 100 profesorë, prej tyre 60 janë burra dhe 40 gra. Ndërkaq, nëse u referohemi të njëjtëve tregues, të Shkollës Fillore “Ibrahim Kelmendi”, raporti mes burrave dhe grave ndryshon. Nga gjithsej 145 mësimit, në këtë shkollë 80 ishin gra dhe 65 burra.

V. NUMRA, MUNDËSI DHE QASJE TË KRAHASUESHME

5. 1. Struktura e popullsisë në Bujanoc e Preshevës sipas nivelit të shkollimit

Komunat e Bujanocit dhe Preshevës zënë një të katërtën e rrethit të Pçinjës, ndërsa për nga numri i banorëve përbëjnë 30 për qindëshin e atyre që jetojnë në këtë rreth. Sipas të dhënave statistikore të popullatës në Serbi⁴⁴, karakteristikë demografike e këtyre dy komunave është se janë të banuara kryesisht me shqiptarë dhe se e kanë të lartë pjesëmarrjen e të rinjve në numrin e përgjithshëm të popullatës ashtu si kurse dhe rritjes natyrore. Statistikat tregojnë se: 54.7 për qind (në Bujanoc) dhe 89.1 për qind (në Preshevë) janë popullsi shqiptare. Serbët në Bujanoc përfaqësojnë 34.1 për qind kurse në Preshevë 8.5 për qind. Sakaq, popullsia rome përfshihet me 8.9 për qind në Bujanoc.

Ndryshe nga Serbia dhe Pçinja, në Bujanoc dhe Preshevë norma e rritjes natyrore është pozitive. Përveç kësaj, karakteristikë e këtyre dy komunave është pjesëmarrja shumë më e madhe e të rinjve dhe pjesëmarrja mjaft e ulët e popullsisë më të vjetër në krahasim me nivelin kombëtar të masave, të shprehura në moshë mesatare, indeksit të plakjes, shkallës së varshmërisë së popullsisë së re dhe normës së varshmërisë së popullatës së moshuar. Këto të dhëna tregojnë një strukturë shumë të favorshme të moshës, të cilat janë një potencial i vlefshëm dhe dinamik për zhvillimin social dhe ekonomik.

Tabela nr.2 Indikatorët demografik

	Serbi	Rrethi i Pçinjës	Bujanoc	Preshevë
Sipërfaqja (në m2)	88499	3520	461	264
Numri i venbanimeve	6158	363	59	35
Numri i banorëve	7.164.132	201.157	38.132	27.254
Dendësia	92	57	83	103
Shkalla e rritjes natyrore	-4.8	-2,1	3	5
Plaka mesatare (në vite)	42,41	38,73	34,52	30,0
Indeksi i plakjes	129,38	80,74	46,88	27, 86

Burimi: Enti Republikan i Statistikave/Komunat dhe regionet në Republikën e Serbisë 2014

⁴⁴ Regjistrimi i vitit 2002

Por, sikurse del nga analiza e resurseve dhe potencialeve kadrovike, i gjithë ai potencial njerëzor, frenohet nga niveli shumë i ulët i arsimit, në nivele fatkeqësisht të larta edhe të rinjtë. Në tabelën më poshtë (nr.3) janë nxjerrë të dhëna statistikore për nivelin e arsimit të banorëve prej moshës 15 vjeçare e lartë, sipas regjistrimit nga viti 2002. Kështu, në Bujanoc dhe Presheve numri i atyre që janë pa shkollë dhe që nuk e kanë kryer arsimin fillor është (26.4% dhe 27.2%) derisa kjo masë në Rrethin e Pçinjës është 24% ndërsa në nivel të Serbisë 19.3%.

Në raport me numrin e përgjithshëm të popullatës, në Bujanoc dhe Preshevë është më e lartë se sa në Pçinjë dhe Serbi edhe përqindja e popullatës me arsim fillor. Kështu në Bujanoc kjo shtresë e popullsisë përbën 3.5% të numrit të përgjithshëm, në Preshevë 37.2 për qind, në Pçinjë 30 për qind dhe në Serbi 21 për qind. Popullata me shkollim të mesëm në Bujanoc dhe Presheve përbëjnë 14.8% dhe 15.9% për dallim prej Rrethit të Pçinjës dhe Serbisë ku popullata me arsim të mesëm përbëjnë 30% dhe 36.2% të popullsisë së përgjithshme. Sa i takon popullsisë më shkollim të lartë dhe universitar komunat e Bujanocit dhe Preshevës janë shumë prapa treguesve të njëjtë në rrafshin kombëtar. Kështu popullsia me arsim të lartë dhe universitar përbën 1.4% dhe 1.8% në Bujanoc dhe 2% dhe 2.4% në

Presheva, për dallim prej Pçinjës e cila ka 2.6% të popullatës me arsim të lartë dhe 3.3% me arsim universitar apo Serbisë e cila ka 4% të popullatës me shkollë të lartë dhe 5.7% me shkollim universitar


Tabela numër 3 (Dallimet komunë/rajon/shtet)

Niveli i arsimit	Serbi	Rrethi i Pçinjës	Bujanoc	Preshevë
Pa shkollë	357.552	19.861	4.622	2.866
Fillore e pa kompletuar	1.022.974	28.624	5.438	3.553
Shkollë fillore	1.509.462	56.293	12.015	10.138
Shkollë e mesme	2.596.384	50.195	5.659	4.335
Shkollë e lartë	285.056	5.291	558	542
Universitet	411.944	6.794	700	652

Burimi: Enti republikan për statistika: Komunitet dhe regjionet në Republikën e Serbisë, viti 2011

Të dhënat në fjalë mjaftojnë për të nxjerrë tablonë e përgjithshme për strukturën arsimore të popullatës, mbi moshën 15 vjeçare, në dy komunat me shumicë shqiptare në Serbi. Kështu, bazuar në të dhëna zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave të Serbisë, në Komunën e Bujanocit përqindja më e madhe e kësaj popullate edhe atë 31.5 për qind janë me arsim fillor, 26.4 për qind janë pa shkollë dhe me arsim fillor të pakompletuar, 14.8 për qind me shkollim të mesëm, 1.4 për qind me shkollim të lartë dhe 1.8 për qind me arsim universitar. Sakaq popullata poshtë moshës 15 vjeçare përbën 34.1 për qind të popullsisë së përgjithshme.


Figura nr.12



Struktura e popullsisë në Komunën e Bujanocit sipas shkallës së shkollimit

Në Komunën e Preshevës situata është me sa vijon: 37.2 për qind me arsim fillor, 27.2 për qind pa shkollë ose me shkollim të pa kompletuar fillor, 15.9 për qind me arsim të mesëm, 2 për qind me shkollë të lartë dhe 2.4 për qind me arsim universitar.

Figura nr.13



Struktura e popullsisë në Komunën e Preshevës sipas shkallës së shkollimit

Shkalla jo e lakmueshme e popullsisë së arsimuar, posaçërisht me arsim të lartë dhe universitar, zvogëlon gjasat për punësim të popullsisë mbi moshën 25 vjeçare, sidomos të femrave.

5.2. Pozita e grave në planet strategjike zhvillimore në Bujanoc dhe Preshevë

Shekulli XXI sikurse dihet ngjiti çështjen e barazive gjinore mes femrave dhe meshkujve, në nivelin e postulateve duke filluar nga definicioni i ILO-s i vitit 2000, Komisionit Evropian 2004, Kartës Evropiane rreth barazisë gjinore 2009, e deri te karta Evropiane rreth barazisë së meshkujve dhe femrave në jetën lokale. Por pavarësisht, vlerave të larta njerëzore dhe morale të cilat përcillen aty si dhe qëllimeve të mira të cilat i vendosin përpiluesit e këtyre dokumenteve, në praktikë realizimi i të njëjtave nuk le edhe aq për tu dëshiruar. *“Barazi gjinore do të thotë që femrat dhe meshkujt të kenë kushte të barabarta për realizimin e të drejtave të tyre njerëzore edhe për të dhënë kontribut por edhe për përfituar nga zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor dhe politik. Prandaj, barazia gjinore nënkupton vlerësimin shoqëror të ngjashmërive dhe dallimeve të meshkujve dhe femrave, si dhe rolin e tyre. Ajo është e bazuar në partneritetin e tyre të plotë në shtëpi, komunitet apo shoqëri. Barazia gjinore fillon me vlerësimin e njëjtë të vajzave dhe djemve”⁴⁵.*

Pjesa dërmuese e hulumtimeve në botë, konfirmojnë mungesën e barazisë gjinore. Deri edhe në vendet më të zhvilluara të Evropës, duke përfshirë shtete skandinave, nuk i kanë përmbushur ende plotësisht objektivat e përcaktuara në dokumentet e Evropës për barazinë e femrave. Në Serbi, situata është edhe më keq. Tranzicioni i tej zgjatur ka shkatërruar pothuajse gjithçka të arritur paraprakisht në fushën e barazisë së grave. Në zonat me një traditë akoma të fortë patriarkale, sikurse është rasti i Bujanocit dhe Preshevës, arritja e objektivave evropiane të barazisë së grave në vendim-marrje në lidhje me jetën e tyre, si dhe emancipimi i plotë është më kompleks dhe i ndjeshëm në përgjithësi⁴⁶. Kjo mund të konstatohet nëse u referohemi dokumenteve zyrtare komunale dhe studimeve që janë bërë në këtë drejtim.

Një studim i Sarita Bradash dhe Nikola Ristivojeviç, për pozitën e grave në Bujanoc dhe Preshevë, lidhur me Planin Strategjik 2007-2014 të Komunës së Bujanocit, vëren se nuk ofrohen të dhëna të mjaftueshme lidhur me pozitën e grave. Thuhet se ka vetëm dy tregues për këtë gjendje edhe atë se “15.5 për qind e popullsisë femërore janë me statusin e analfabetes”, dhe tjera që ka të bëjë me sferën e (pa)punësimit dhe mbrojtjes sociale e ku

⁴⁵ ILO (2000) ABC e të Drejtave të Grave të Punës dhe Barazisë Gjinore, Gjenevë.

⁴⁶ Pozita e femrave, ... në komunat e Bujanocit dhe Preshevës”, studim Sarita Bradaš dhe Nikola Ristivojević, 2015

thuhet se “bazuar në kualifikimin, moshën dhe strukturën gjinore, pozita e femrave është shumë e pafavorshme”.

Për Planin Strategjik Zhvillimor të Komunës së Preshevës, 2011-2017, thuhet se ka një Plan Veprimi, i cili i kushton vëmendje “nxitjes së sipërmarrësish së grave, veçanërisht në fushën e turizmit nëpërmjet edukimit”. 66 për qind e të papunëve në këtë komunë thuhet se janë gra. Sakaq, sipas shkallës së zhvillimit për vitin 2014 komunat e Bujanocit dhe Preshevës janë klasifikuar në zonat e shkatërruara me nivelin e zhvillimit nën 50 për qind të mesatares kombëtare. Sipas Byrosë Republikane të Statistikave për muajin maj 2015, paga mesatare, pa taksa dhe kontribute janë më të ulëta se mesatarja kombëtare (43.964 RSD) edhe atë për deri 31.6 për qind në Bujanoc dhe për deri 24 për qind në Preshevë⁴⁷

Një fenomen tjetër që është pashmangshmërisht i lidhur me nivelin e arsimit është edhe papunësia. Në të dyja këto komuna, nga viti 2008 është çdo herë e në rënie numri i të punësuarve. Kështu, në vitin 2014, në Bujanoc numri i të punësuarve ishte për 35 për qind më i ulët kurse në Preshevë për 14 për qind në krahasim me numrin e të punësuarve në vitin 2008. *“Pa barazi në politike, ekonomike dhe çdo formë tjetër të vendimmarrjes, nuk ka asnjë mundësi që barazia gjinore të integrohet në politikë-bërjen e qeverisë. Pa pjesëmarrjen aktive të grave në procesin e ndërtimit të shoqërisë tonë si një vend modern, europian të profilizuar dhe demokratik, nuk është i mundur realizimi i demokracisë, barazisë së progresit social “*

Studimet mbi statusin e gruas në nivel shteti (në Serbi) të kryera së fundmi tregojnë qartë diskriminimin me bazë gjinore edhe në tregun e punës. Proceset e tranzicionit në Serbi çuan në humbjen e të drejtave të fituara dhe përfitimet në të gjitha fushat: ekonomike, sociale dhe politike. Rritja e papunësisë, rënia në punësim, ulja në aktivitetin ekonomik, kthimi në rolin tradicional të amviseve dhe nënës, rënia e pjesëmarrjes në pozita vendimmarrëse, janë vetëm disa tregues të përkeqësimit të situatës së grave. Kriza ekonomike në Serbi edhe më tej ka përkeqësua kushtet e punësimit, veçanërisht për gratë.

Sipas të dhënave nga Enti Republikan për Statistika përqindja e aktiviteteve të grave në moshë është më e ulët për 17 për qind se norma e aktiviteteve të meshkujve (53% dhe 70%); përqindja e femrave në mesin e të punësuarve është më e vogël se pjesa e meshkujve (42% dhe 58%); shkalla e papunësisë së femrave në grupmoshën 15 deri 24 ishte 12 për qind më e lartë se shkalla e papunësisë për burrat në të njëjtën grupmoshë (57% dhe 45%); gratë janë të përfaqësuara në mesin e bartësve të fermave me 17.3%, dhe përbëjnë shumicën në mesin e familjarëve dhe të afërmve që kryejnë aktivitete bujqësore në

⁴⁷ Po aty, fq 16

fermë (62.9%, burrat 37.1%), ndërsa në mesin e punëtorëve të përhershëm në ferma përbëjnë një minoritet të dallueshëm (14,8%, meshkujt 85.2%).

Gratë në Bujanoc dhe Preshevë janë shumë pak të përfaqësuara në mesin e të punësuarve në raport me mesataren kombëtare (me 9 për qind në Bujanoc dhe gati 20 për qind në Preshevë). Arsye për këtë është fakti se në një shoqëri tradicionale, gratë hyjnë në tregun e punës në numër më të vogël se sa meshkujt, që tregon shkallën e aktivitetit të grave në Bujanoc (21.10%) dhe Preshevë (27.25%), që është dukshëm më e ulët se norma e aktiviteteve të grave në Serbi (34%). Në kontekstin socio-ekonomik tregohet fakti se numri më i madh i të punësuarve në këto dy komuna është në sektorin publik (arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe administratë publike), në Bujanoc 42% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve, kurse në Preshevë 56%, kështu që është reale që hendeku gjinor është më i vogël në punësim në subjektet juridike, që do të thotë se të dhënat në nivel kombëtar tregojnë se përqindja e femrave të punësuar në sektorin publik është më e madhe se përqindja e meshkujve (kujdesi shëndetësor dhe shoqëror 78.7%, arsim 68.7%, administratë publike dhe sigurim social i detyrueshëm 59%).

Por ku janë në pyetje pozitat e larta drejtuese në sektorin publik, numri i grave në Bujanoc dhe Preshevë është i papërfillshëm. Kështu, në pozitat udhëheqëse në ndërmarrjet publike, institucionet e administratës shtetërore dhe gjyqësorit në Bujanoc janë 59 meshkuj dhe 6 femra, kurse në Preshevë 51 meshkuj dhe 4 gra. Edhe pse gratë janë më të përfaqësuara si të punësuar në këtë sektor, pothuajse nuk ekziston mobiliteti vertikal i grave në pozicione drejtuese.

Shkalla e arsimit, kohëzgjatja e pritjes për punësim si dhe mosha, janë faktorët kryesorë për pozitën e pafavorshme të femrave në tregun e punës. Në regjistrat e personave të papunësuar në Bujanoci, sipas të dhënave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) për vitin 2014, kishte 4.214 persona (51% femra, 49% meshkuj) dhe në komunën e Preshevës 5,153 persona (56% femra, 44% meshkuj). Struktura arsimore e të papunëve është shumë e pafavorshme. Në mesin e të papunëve në Bujanoc dhe Preshevë shumica e të papunëve janë pa kualifikim, 58% në Bujanoc dhe në Preshevë 62%. Pjesëmarrja në mesin e grave të pakualifikuara në Bujanoc është 68%, dhe në Preshevë është 45%. Me arsim të mesëm në mesin e grave të papuna janë 26% në Bujanoc dhe 52% në Preshevë.

Pjesëmarrja e grave të papunësuar me arsim të lartë dhe fakultet, është shumë e ulët, 6 për qind në Bujanoc dhe 3 për qind në Preshevë.

Tabela 3

Niveli i arsimit te personat e papunësuar sipas gjinisë						
	Bujanoc			Preshevë		
	gjithsej	fem.	mesh.	gjithsej	femra	meshkuj
Pa kualifikim	2442	1460	982	3196	2173	1023
Shk. e mesme	1529	568	961	1826	645	1181
E lartë	142	82	60	64	29	35
Fakultet	101	50	51	67	32	35

Në mesin e të papunësuarve pa kualifikime në Preshevë dy të tretat (68 për qind) janë femra. Në Bujanoc është diçka “më mirë”, 45 për qind, për dallim prej pjesëmarrjes së ulët të grave me fakultet dhe arsimim të lartë (në Bujanoc 6% dhe në Preshevë 3%). Përveç kësaj, gratë presin punë më gjatë se burrat. Për qindja e femrave në mesin e të papunëve afatgjatë në Bujanoc është 64 për qind dhe në Preshevë 70 për qind. Të papunësuarat janë në moshat e tyre më produktive, nga 30 deri 49 vjet⁴⁸. Shqetësim plotësues sa i takon pozitës së femrave në Bujanoc dhe Preshevë përbën prezencë simbolike në vende drejtuese. Në Bujanoc kjo përfshirje nuk kalon 10 përqindëshin, ndërsa në Preshevë është vetëm 3 për qind edhe atë me vetëm një grua drejtore në mesin e të gjithë ndërmarrjeve publike, institucioneve të administratës shtetërore dhe gjyqësorit.


⁴⁸ po aty, fq 40

5.3 Anketa dhe rezultatet

Opinionit që kanë nxënësit për diskriminimin apo pabarazitë gjinore është padyshim një tregues i rëndësishëm që ndihmon në nxjerrjen e konkluzioneve sa i përket këtij hulumtimi. Duke qenë palë e involvuar dhe e tanguar në trajtimin e tezës së magistraturës, u pa e udhës që të bëhen pjesë e hulumtimit duke u marrë në konsideratë vlerësimet e tyre rreth çështjes në fjalë. Që opinionit i nxënësve të jetë sa më i kompletuar, vendosëm të anketojmë jo vetëm nxënës të shkollave të mesme por edhe nxënës të shkollave fillore. Por që të mos ketë dallim të madh moshe me nxënësit e shkollave të mesme (arsyja e parë) dhe që të jenë në moshës relativisht të avancuar të zhvillimit psikomotorik (arsyja e dytë) u përcaktuam që në Shkollën Fillore “Ibrahim Kelmendi” të anketohen nxënës të klasave të shtata dhe të teta, me atë që kjo kategori e të anketuarve të përbën $\frac{1}{4}$ e numrit të përgjithshëm (20 nxënës) kurse në gjimnazin “Skënderbeu” dhe Shkollën e Mesme Profesionale “Presheva” nga 30 nxënës në secilën. Pra u morr mendimi i gjithsej 80 nxënësve, prej të cilëve 40 vajza dhe 40 djem.


E në fakt, në pyetje të cilat synojnë të marrin përgjigje nëse në shkollë ekziston ose jo diskriminimi gjinor apo nëse vajzat dhe djemtë trajtohen njëjloj, pjesa dërmuese e të anketuara në shkollën fillore ose nuk përgjigjen ose përcaktohen për përgjigjen “nuk e di”. Pra, duket se në këtë grup moshë nxënësit nuk kanë një ide të qartë rreth pabarazisë, respektivisht diskriminim. Kjo është pyetja e parë e anketës e formuluar me sa vijon: Në klasën tonë, vajzat dhe djemtë, a) trajtohen njëjloj; b) trajtohen ndryshe dhe c) nuk e di. Nga 20 nxënës të kësaj grup moshe 17 kanë rrethuar si të saktë përgjigjen “c”, dy kanë rrethuar përgjigjen “b” dhe një ka rrethuar përgjigjen “c”. Ndërkaq të anketuarit e shkollave të mesme në masë më të madhe mbajnë qëndrim. Konkretisht vetëm 15 nxënës (7 të vitit të parë, 6 të vitit të dytë dhe nga 1 të vitit të tretë dhe të katër) kanë rrethuar përgjigjen “c”. Të tjetër kanë mbajtur qëndrim, pra 22 kanë rrethuar përgjigjen “a” dhe 23 përgjigjen “b”. Sa i takon kësaj pyetje nuk ka dallime në ndarje gjinore. Në këto karakteristika konsiston përcaktimi i nxënësve nëse në shkollë ka diskriminim të vajzave (pyetja numër 5) të cilën do ta analizojmë pak më vonë. Tani të shohim se di duket ndarja e nxënësve për pyetjen e parë sipas grupmoshave.

Figura 14& 15



Në pyetje e dytë "Në shkollë, privilegohen më shumë", a) djemtë; b) vajzat dhe c) nuk ka dallime është interesante se vajzat në masë të madhe kanë rrethuar përgjigjen "b". Edhe atë, për të gjitha grupmoshat (nga 40 vajza gjithsej) 27 janë përgjigjur për këtë opsion, kurse 7 se nuk ka dallime, pra kanë rrethuar përgjigjen "c" dhe 6 janë përgjigjur për opsionin se djemtë janë më të privilegjuar, pra kanë rrethuar përgjigjen "a". Te përgjigjet e djemve dominojnë gjithashtu përgjigjet e opsionit "b" (25) dhe pas saj "c" (12) dhe "a" (3). E paraqitur në figurë opinion i vajzave dhe djemve është si në vijim


Figura 16 & 17



Në pyetjen e tretë dhe të katërt ku prej nxënësve kërkohet të mësohen arsyet që sipas tyre i bëjnë vajzat nxënëse më të mira (pyetja numër 3) dhe djemtë nxënës më të mirë (pyetja numër 4) u jepet mundësia të dyja palëve të shprehin rivalitetin që kanë ndaj njëri-tjetrit. Konkretisht djemtë në masë të madhe e lidhin suksesin e vajzave me tiparet fizike, ndërsa të këtiilla shfaqen edhe vajzat kur duhet të tregojnë arsyet përse djemtë marrin nota më të mira. Në pyetjen e cila është formuluar “Vajzat, marrin nota më të mira se djemtë”, a) sepse janë vajza (gjinia e bukur); b) sepse janë më të urta; c) sepse mësojnë më shumë dhe d) nuk marrin nota më të mira, pjesa dërmuese e lidhin suksesin me fizikun dhe tiparet karakteristike të gjinisë femërore. 12 djem kanë rrethuar si të saktë përgjigjen “a”, 17 përgjigjen “b”, 8 përgjigjen “c” dhe 3 përgjigjen “d”.

Me të njëjtin botëkuptim përceptohen djemtë nga ana e vajzave. Në pyetjen numër 4 “Djemtë, marrin nota më të mira se vajzat”; a) sepse bëhen shokë me profesorët, b) sepse janë më të fortë, c) sepse mësojnë më shumë dhe d) nuk marrin nota më të mira, edhe te vajzat është tendenca që suksesin e mësimeve të djemtë ta shohin të atribuuar nga faktorë të tjerë. Kështu 15 vajza janë përgjigjur me variantin “a”, 8 me variantin “b”, 12 me variantin “c” dhe 5 me variantin “d”. Pra, si djemtë ashtu edhe vajzat e përshkruajnë shumë pak suksesin e gjinisë së kundërt me meritokracinë. Vetëm 8 nga 40 djem mendojnë se vajzat i meritojnë notat, pra marrin nota më të mira sepse mësojnë më shumë dhe vetëm 12 nga 40 vajza e mendojnë të njëjtën gjë për djemtë.

Figura 18 & 19



Pyetja numër 5 e cila kërkon të marrë përgjigje nëse “në shkollë ka diskriminim të vajzave” edhe pse e ndarë në katër përgjigje të mundshme konfirmon prezencën e diskriminimit, sidomos nga të anketuarit e shkollave të mesme. Grupmosha e nxënësve të shkollave fillore, sikurse nënvizuar edhe më lartë janë ato që në masën më të madhe janë përgjigjur me “nuk e di” (përgjigja “d”), ndërsa nxënësit e shkollave të mesme përcaktohen ose për “çdo herë” (përgjigja “a”), “ndonjëherë” (përgjigja “b”) apo “asnjëherë” (përgjigja “c”). Të analizuar si një tërësi e vetme, për përgjigjen “a” janë përcaktuar vetëm 3 nxënës, për përgjigjen “b” 55 nxënës; për përgjigjen “c” 7 nxënës dhe për përgjigjen “d” 15 nxënës (11 nga 20 filloristë dhe 4 nga 60 të shkollës së mesme)

Figura 20




Nxënësit janë të ndarë edhe sa i takon perceptimit rreth shoqërimin të djemve dhe vajzave gjatë pushimit mes orëve të mësimin dhe këtë e tregojnë rezultatet e pyetjes numër 6 të Anketës. Konkretisht, 12 nxënës janë përgjigjur se “shumicën e rasteve, vajzat qëndrojnë vetëm dhe djemtë vetëm” (“a”), 43 nxënës se “shumicën e rasteve, vajzat dhe djemtë qëndrojnë bashkë” (“b”) dhe 25 nxënës se “në disa raste qëndrojnë vetëm e kuptim shoqëria, në disa raste, bashkë” (“c”).

Për anketimin e nxënësve, qëllimisht janë dhënë disa pyetje prej të cilave kërkohet përgjigje vetëm nga djemtë dhe disa vetëm nga vajzat. Të pyetur ndaras (pyetjet me numër 7 dhe 8) për rëndësinë që ka në shoqëri gjinia e kundërt, djemtë përgjigjen për vajzat mesa

vijon: 8 se “janë të këndshme” (“a”), 9 se “janë të mërzitshme”, 4 se “janë të pa nevojshme” dhe 19 se “pa to nuk ka kuptim shoqëria” (“d”). Ndërkaq, vajzat për djemtë thonë: 13 se “janë të këndshëm” (“a”), 5 se “janë të mërzitshëm”, 8 se “janë të pa nevojshme”, 12 se “pa ata nuk ka kuptim shoqëria” (“d”), kurse dy nuk janë prononcuar fare për këtë pyetje.

Të pyeturit tregojnë një tipar që më së shumti do ti përshtatej gjinisë së kundërt (pyetjet me numrin rendor 9 dhe 10) djemtë bëjnë këtë vlerësim për vajzat: 14 se “shohin interesin dhe janë dinake” (“a”); 17 se “janë ngatërrestare dhe bëjnë thashetheme” dhe 9 se “janë besnike dhe të sinqerta”. Për të njëjtat tipara, vajzat përcaktohen pak më ndryshme për djemtë: 18 se “shohin interesin dhe janë dinak” (“a”); 7 se “janë ngatërrestar dhe bëjnë thashetheme” dhe 15 se “janë besnik dhe të sinqertë”.

Figura 21 & 22



Të pyetur përsëri për gjininë e kundërt, në pyetjet 11 dhe 12 djemtë thonë se vajzave u bëhet më tepër padrejtësi në: familje (6), shtëpi (6) dhe shoqëri (28). Ndërkaq vajzat thonë për djemtë se u bëhet më tepër padrejtësi në: familje (10), shkollë (22) dhe shoqëri (8).

Përfundimi

Prezenca e gjinisë femërore në institucionet arsimore, në Luginë e Preshevës është e lartë, madje më e avancuar se sa prezenca e gjinisë mashkullore. Mirëpo, përfaqësimi sasior nuk korrespondon me përfaqësimin cilësor. Prandaj, nevojitet përpilimi i një Strategjie të mirëfilltë, objektivat e së cilës do të lidhen drejtpërdrejtë me integrimi kualitativ të femrave në shoqëri, e me theks të veçantë institucionet arsimore në përgjithësi. Por që kjo të ndodh, ndryshimi duhet të nis që nga kurrikula mësimore e cila ka ndikim të madh në formimin intelektual të nxënësve. Fatkeqësisht, në tekstet shkollore përfaqësimi i gjinisë femërore është inferior karshi gjinisë mashkullore, dhe kjo ndikon në kultivimin e mentalitetit se në shtëpi “burri është ai që lexon gazeta” dhe gruaja “ajo që bën punët e shtëpisë”. Nuk është e rastësishme që disa profesione janë të rezervuara për burrat e disa për gratë. Kjo logjikë, jo vetëm që reflektohet por bëhet shkak-pasojë edhe në orientimin e nxënësve/studentëve në drejtimet e shkollave të mesme, respektivisht fakulteteve.

Përfshirja e vogël e grave në pozita vendimmarrëse, është gjithashtu një situatë të cilën duhet ndryshuar, nëse dëshirojmë të bëhemi pjesë e trendeve pozitive të zhvillimeve në botë si në sferën e arsimit ashtu edhe të tregut të punës. Pasi vetëm kështu shoqëria shqiptare e Luginës së Preshevës do të zhvillohet në tërësinë e plotë të saj. Paragjykimet të cilat na ndjekin sot e kësaj dite, si mungesa e ndërgjegjësimit të vetë gjinisë femërore për integrim, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin më të ulët të arsimimit të vajzave dhe në tregues të tjerë negativ, si për shembull shkalla më e lartë e papunësisë e cila karakterizon gratë. Përgjegjësia më e madhe për këtë, natyrisht se i takon shkollës, pasi pavarësisht ndikimeve që kanë në formimin e individit familja, mjedisi, masmediat apo edhe aktivistët e organizatave joqeveritare, rolin kryesor në edukimin dhe shkollimin e tyre duhet ta kenë institucionet arsimore. Në këtë kontekst, roli i mësimdhënësve do të duhej të ishte i pazëvendësueshëm.

Paragjykimet dhe stereotipat janë të pranishme te nxënësit sidomos te ata që janë në nivelin e mesëm të shkollimit.

Rekomandimet

- Shkolla përmes instrumenteve të saj (kurrikulave, testeve shkollore dhe mësimdhënësve) duhet të angazhohet për shembjen e stereotipave sa u takon roleve që kanë femrat dhe meshkujt në shoqëri.
- Angazhimi i shoqërisë civile në vetëdijesimin e masave për rëndësinë e barazisë gjinore, duke përfshirë nxënësit si target-grup, është më se i domosdoshëm.
- Të insistohet në gjetjen e një mekanizmi ligjor i cili do të bëhet obligueshëm përfaqësimin e femrave në pozita vendimmarrëse në institucionet arsimore.
- Të kërkohet që jo më pak se 30 për qind e drejtorëve të shkollave, këshilltarëve dhe inspektorët arsimor, si dhe përgjegjësve komunal të nivel rajonal dhe shtetëror - të jenë femra.
- Të kërkohet në ato shkolla të cilat kanë drejtorë (burra) të kenë domosdo të gjinisë të kundërt (femra) kryetaren e Këshillit Drejtues të Shkollës.
- Sholla dhe sipërmarrësit duhet të punojnë ngushtë me njëra tjetrën për të vendosur baraspeshën në kualifikimin e femrave sipas profesioneve për të cilat ka nevojë tregu i punës.
- Për barazinë e plotë gjinore, duhet të përpiqen edhe partitë politike të Luginës, pasi pa arritjen e këtij synimi nuk mund të ketë as barazi politike, ekonomike e kulturore të shqiptarëve të cilët jetojnë në shtetin e Serbisë

Bibliografia

Fjalori i gjuhës sotme shqipe, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë (1990)

Jashari Hasan "Sociologjia e Arsimit" "Interlingua" Shkup (2005)

Zylfiu Ilir "Arsimi Shqip në Luginë të Preshevës gjatë shek XX" Instituti Albanologjik, Prishtinë (2002)

Berisha S.Tahir "Emrat që nuk harrohen" Prishtinë (1994)

Beauvoir de Simone "The Second Sex"

Lovenduski Joni "Gendering Politics, Feminising Political Science, ECPR Press 2015"

Kalaja Daniela, dis "Përfaqje të krahasuara gjinore në hapësirën midis regjistrimeve dhe diplomimeve në Shqipëri" Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (2013)

"Pozita e femrave në tregun e punës dhe zhvillimi i ndërmarrësisë së femrave në komunat e Bujanocit dhe Preshevës", studim Bradaš dhe Nikola Ristivojević, bot: Shoqata e grave afariste në Bujanoc

"ABC-ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian, Klaus-Diter Borçard, Bashkimi Evropian (2010)

Planin Strategjik Zhvillimor i Komunës së Preshevës (2011-2017)

"Përkufizimet dhe konceptet gjinore", Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovës, ribotim(2012), Prishtinë

Doc.dr Kastrati Sela Flora "Sociologji e gjinive" punim seminarik, Universitetin e Tiranës

Dr.Demir Zekija "Feminizmi modern dhe postmodern" punim seminarik

"Mbrotjtja sociale dhe përjashtimi social në Ballkanin Perëndimor" Instituti i Ekonomisë në Zagreb (2009)

Установе за децу предшколоцког узраца, број 99 – год. LXVII (21.04.2017)

"Institut za razvoj obrazovanja", Eurostudent V, Nacionalno Izvešće Istraživanja za Hrvatsku, Zagreb (2014)

Webogafia

<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/inequality>

<https://en.oxforddictionaries.com/definition/inequality>

<http://ëëë.businessdictionary.com/definition/income-inequality.html>

<http://ëëë.stat.gov.rs/oblasti/obrazovanje/predskolsko-vaspitanje-i-obrazovanje>

<ëëë.evropaelire.org/a/dy-e-treta-e-vajzave-afgane-nuk-shkollohen-/28799481.html>

<https://archive.koha.net/?id=7&l=102309>

[\[84\]\(http://zeri.info/aktuale/175893/tekstet-mesimore-nxisin-pabarazine-gjinore/<u>http://zeri.info/aktuale/175893/tekstet-mesimore-nxisin-pabarazine-gjinore/</u></p></div><div data-bbox=\)](https://lllonline.com/keshilli-kombetar-shqiptar-ska-interesim-per-zgjidhjen-e-librave-shqip/<u>https://lllonline.com/keshilli-kombetar-shqiptar-ska-interesim-per-zgjidhjen-e-librave-shqip/</u></p></div><div data-bbox=)